



FEJA, LAICITETI DHE HAPËSIRA PUBLIKE

*Shtypi shqiptar për raportet mes fesë,
laicitetit dhe hapësirës publike
Shtator 2011 - Qershor 2012*



FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

Feja, laiciteti dhe hapësira publike

*Shtypi shqiptar për raportet mes fesë, laicitetit
dhe hapësirës publike*

Shtator 2011 - Qershor 2012



**FRIEDRICH
EBERT 
STIFTUNG**

Ky studim u mundësua në saj të mbështetjes financiare të
fondacionit Friedrich Ebert Stiftung



Shkruar nga Piro Misha

Hulumtues: Alma Gjoka
Valbona Lila



Instituti i Dialogut dhe Komunikimit
(ish shtëpia e Librit dhe Komunikimit)
Rr. Pjetër Budi, Pall Klasik, Nr. 11, Tiranë
Tel. +355 4 4507853
Email: idd@idd-al.org

Përmbajtja

Në vend të hyrjes	5
Pse ky studim?	8
Shtypi shqiptar për raportet mes fesë, laicitetit dhe hapësirës publike shtator 2011- qershor 2012	13
Censuri i popullsisë dhe përkatësia fetare	25
Feja dhe politika	31
Shteti, bashkësitë dhe institucionet fetare	34
Çështja e varrezave publike	37
Shkrime të tjera që lidhen me këtë temë	40
Shtypi kosovar për temën e fesë, laicitetit dhe hapësirës publike	45
Gallup: Kosovarët qytetarët më religjiozë të Ballkanit, ata të Shqipërisë më joreligjiozët	47
Debatet për laicitetin e arsimit publik	49
Shtetësimi për praninë në Kosovë të lëvizjeve radikale islamike	55

Shtypi kosovar për ngjarjet në Maqedoni	58
Disa përfundime	62

NË VEND TË HYRJES

Objektivi i këtij studimi është të japë një pasqyrë sa më të saktë të mënyrës sesi media shqiptare (kryesisht ajo e shkruar) ka pasqyruar e trajtuar temën e raporteve mes laicitetit (shkullarizmit) dhe vendit që feja (apo simbolet e saj) zënë apo duhet të zënë në hapësirën publike shqiptare. Studimi mbulon një periudhë gjashtë deri në nëntë mujore, duke përfshirë tre mujorin e fundit të vitit të shkuar si dhe gjysmën e parë të vitit 2012 (shtator 2011 - qershor 2012). Pra, në përgjithësi, në të do të jenë pasqyruar debatet që kanë spikatur gjatë kësaj periudhe në lidhje me këtë temë, duke nisur nga ajo e lejimit apo moslejimit të shfaqjes së simboleve fetare (sidomos çështja e vazave të mbuluara myslimane) nëpër shkollat publike, e deri tek diskutimet e kohëve të fundit lidhur me projektligjin e paraqitur në Parlament nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë, në të cilin për herë të parë parashikohet përfshirja e edukimit fetar në arsimin publik të vendit.

Sigurisht, studimi s'do mjaftohet vetëm e thjeshtë me informacionin për mënyrën sesi është mbuluar mediatikisht kjo temë. Në fund do bëhen përpjekje për të nxjerrë disa përfundime e analizuar deri diku, disa prej prirjeve dhe problemeve kryesore që spikasin gjatë kësaj periudhe kohore, por dhe, më në përgjithësi, gjatë viteve të fundit. Për t'ia arritur kësaj, sigurisht, do jemi të detyruar që, pavarësisht se vështrimi përqendrohet në një periudhë të kufizuar, do t'i referohemi një sërë dukurish dhe sidomos debatesh që, edhe pse mund të kenë ndodhur më parë, vazhdojnë të jenë domethënëse kur vjen puna për të kuptuar e shpjeguar prirjet, dukuritë e tensionet kryesore të vërejtura gjatë viteve të fundit në raportet mes laicitetit, si një ndër parimet kryesore kushtetues mbi të cilët është e organizuar jeta

publike e vendit, dhe presionit për një prani gjithnjë e më të madhe të fesë dhe simboleve të saj në hapësirën publike të vendit. Fjala është, para së gjithash, për një sërë debatesh apo dhe ngjarjesh të ndodhura gjatë këtyre viteve të fundit, që në një mënyrë a një tjetër lidhen me temën tonë, të cilat kanë patur një vëmendje të madhe e të pazakontë mediatike, të cilat vlejnë njëkohësisht për të kuptuar më mirë ndjeshmëritë e ndikimet që ekzistojnë në ambiente të ndryshme të opinionit publik.

Këtu fjala është, sigurisht, para së gjithash, për debatin e paradokohshëm për identitetin kombëtar shqiptar dhe vendin që zë feja (islami) në formësimin e tij. Në këtë debat u përfshinë një numër mjaft i madh personalitetesh të kulturës e jetës publike shqiptare, por protagonistë kryesorë qenë dy prej figurave qendrore të hapësirës publike shqiptare: shkrimtari i njohur Ismail Kadareja dhe studiuesi Rexhep Qosja, nga Prishtina. Po ashtu, debatet e para disa vitesh për shtatoren e Nënë Terezës dhe në përgjithësi, përdorimin e shëmbëlltyrës së saj, si dhe sigurisht debatet e herëpashershëm për praninë apo jo të simboleve fetare në shkolla, e më në përgjithësi, në ambientet publike. Le të kujtojmë këtu debatet e paradokohëshme për vendosjen e disa kryqeve në vende që ngjallën kontestime, diskutimet për thirrjen zëllartë me altoparlantë të xhamive. Dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, diskutimet e shqetësimet e shprehura për ndërhyrjen e mundshme të fesë në politikën shqiptare apo dhe thjeshtë, në ligjërimin e saj.

Po ashtu, në fund të studimit, duke u bazuar në materialin e mbledhur, do mundohet të ravijëzohen fare shkurt, disa skenarë të mundshëm përse i takon së ardhmes së afërt.

Mund të thuhet se, pavarësisht nga pesha që ka patur në debatin publik, kjo (në dijeninë tonë) është hera e parë që bëhet një përpjekje e tillë sistematike për të hetuar mënyrën sesi është trajtuar e perceptuar problematika e raporteve mes laicitetit dhe fesë në shoqërinë shqiptare, duke identifikuar çështjet dhe problemet për të cilat mund të debatohet dhe që potencialisht mund të krijojnë probleme, apo dhe tensione në një të ardhme.

Shqyrtimi ynë është i përqendruar sigurisht, në radhë të parë në Shqipëri dhe në median e Shqipërisë, ku historikisht ekziston gjithnjë një ndjeshmëri e veçantë përsa i takon dinamikës së këtyre raporteve. Po ashtu, duhet thënë se për arsye praktike, studimi mbulon kryesisht median e shkruar dhe më pak atë elektronike, e cila do kërkonte një tjetër nivel monitorimi që ne s'i kishim mundësitë ta bënim në kuadër të këtij studimi.

Në studim ka gjithashtu, një pjesë të veçantë që i kushtohet medias së Kosovës: debateve të zhvilluara gjatë së njëjtës periudhë aty për këtë temë. Sigurisht, në këtë rast, kemi të bëjmë me një vështrim disi më të përmbledhur, pa asnjë pretendim shterues, Kjo për arsyen e thjeshtë se, pavarësisht nga specifikat dhe dallimet që ekzistojnë në këtë aspekt në secilin prej këtyre tre territoreve të banuara nga shqiptarë, s'ka asnjë dyshim se për një mori arsyesh mes tyre ekziston një lidhje e kontaminim reciprok që s'mund të neglizhohet.

Si përfundim, duke u munduar të japim një vështrim sistematik dhe gjithëpërfshirës të disa prej aspekteve më të rëndësishëm që aktualisht karakterizojnë raportet mes laicitetit (si një parimet kryesorë organizativë dhe kushtetues të Republikës së Shqipërisë), fesë dhe vendit që ajo dhe simbolet e saj zënë në hapësirën publike, objektivat kryesore që synohet të arrihen nga ky studim janë dy:

- Të ofrojë një vështrim të përgjithshëm të atyre çështjeve që ekzistojnë, si dhe të gjithë shqetësimeve, frikërave, pretendimeve, pritshmërive dhe ankesave që karakterizojnë debatin për raportet mes laicitetit dhe fesë në sferën publike.
- Të ndihmojë për një ndërgjegjësim publik përsa i takon problemeve, sfidave dhe rreziqeve që mund të sjellë në kohën e globalizimit për një vend si Shqipëria, konfuzioni, ambiguiteti apo improvizimi që ka rrethuar deri tani një fushë si kjo, kaq të rëndësishme kur vjen puna për të ruajtur balancat që kanë ekzistuar tradicionalisht në një vend si Shqipëria, por në fund të fundit, edhe vetë kohezionin fetar.

Pse ky studim?

Para së gjithash, për vetë rëndësinë që ka kjo temë për realitetin shqiptar. Në fakt, laiciteti ka qenë (së paku që nga krijimi i shtetit shqiptar) një ndër parimet kryesore organizative të jetës sonë të përbashkët. Po ashtu, historikisht, si gjatë procesit të kombkrijimit, ashtu dhe më pas, atij të shtetformimit të shqiptarëve, laicitetit (shekullarizmi) përbënte një ndër gurët kryesorë të themeleve mbi të cilët u ngrit ajo bashkëjetesë shembullore mes bashkësive të ndryshme fetare tradicionale, nga të cilat përbëhej popullsia shqiptare, çka përbën një ndër tiparet dalluese të Shqipërisë gjatë gjithë shekullit të XX, e më tej.

Në fakt, duhet thënë se laiciteti, pra përpjekja për të bërë një ndarje të qartë mes përkatësisë fetare dhe asaj kombëtare, si një konstante e historisë moderne të komb dhe shtetformimit të shqiptarëve, e ka zanafillën që me atë që ne zakonisht e quajmë Rilindja Kombëtare, pra që në atë periudhë kur nis një lëvizje e organizuar kombtariste shqiptare në dekadat e fundit të shekullit të XIX. Në dallim nga thujtja gjithë lëvizjet e tjera të kësaj natyre në gadishullin ballkanik, ku feja luajti një rol të rëndësishëm si faktor kohezioni dhe identifikimi, lëvizja kombëtare shqiptare pati që në fillimet e saj një karakter të theksuar laik, duke qenë se shihte te feja jo vetëm një ndër pengesat më të mëdha në rrugën e krijimit të një kohezioni e uniteti kombëtar, por po ashtu dhe një instrument nëpërmjet të cilit “armiqtë” e shqiptarëve mund të ushtronin ndikimin e tyre të rrezikshëm përçarës. Kjo qasje në fakt, që e kushtëzuar nga vetë përbërja fetare e shqiptarëve, të ndarë, siç dihet, në tre fe e katër besime, çka kishte kontribuar dhe tek vonesa e tyre historike në krahasim me popujt fqinjë në rrugën e ngritjes së një lëvizjeje kombëtare. Siç dihet, kjo filozofi sintetizohet në vargjet e bëra tashmë të famshme të poetit e politikanit të Rilindjes Kombëtare shqiptare, Vaso Pasha: “Feja e vërtetë e shqiptarit është shqiptaria.”

E njëjta filozofi, ose bindje për domosdoshmërinë e një ndarjeje të qartë mes politikës dhe institucioneve të jetës së përbashkët,

karakterizon qartazi gjithë historinë shqiptare të shekullit të XX, ku sërish, laiciteti kthehet në një ndër dogmat kryesore të organizimit të shtetit të ri shqiptar. Kjo pasqyrohet qartazi dhe në kushtetutën e parë të shtetit shqiptar të vitit 1928, në të cilën thuhet: “*Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare. Të gjitha fetë dhe të gjitha besimet respektohen dhe garantohet ushtrimi i tyre i lirë. Feja në asnjë mënyrë nuk mund të shërbejë si ndalesë dhe pengesë juridike e çdo lloji. Feja dhe besimi nuk mund të përdoren për realizimin e synimeve politike. Parimet e politikës fetare të shtetit janë: laiciteti i shtetit, liria fetare, barazia e feve, nënshtrimi i tyre ndaj shtetit.*”

Jo rastësisht, qeveria e parë shqiptare e dalë nga Kongresi i Lushnjës, e ashtuquajtura regjencë, përbëhej nga katër përfaqësues që përfaqësonin katër besimet ekzistuese në vend, të përfaqësuara pra në mënyrë të barabartë, pa një koncept shumice e pakice.¹

Në këtë vështrim, gjatë periudhës së parë të shtetit shqiptar, pra që prej krijimit të tij, deri në pushtimit italian të Shqipërisë në prill të vitit 1939, kemi një dukuri që mund të quhet **nacionalizim i fesë**, që nënkuptonte përpjekje për të vënë thujt nën kontroll të plotë nga ana e shtetit të institucioneve fetare të vendit, si dhe minimizimin ose vënien nën kontroll të lidhjeve apo financimeve të tyre nga jashtë. Duhet vënë po ashtu në dukje, se përse i takon laicitetit, modeli i adaptuar që ai francez, që nënkuptonte jo vetëm një ndarje të shtetit nga feja, por dhe ndarjen e qartë të sferës fetare nga ajo publike. Gjatë periudhës së mbretërisë, modeli që u adaptua është mjaft i ngjashëm me atë kemalist në Turqi, duke u shoqëruar me ndërmarrjen e një sërë masash praktike. Ndër to mund të përmenden, qoftë dhe për analogji me diskutimet e sotme, masat e ndërmarra nga mbreti Zog për kontrollin e financimit dhe emërimeve në institucionet fetare, kufizimin e shkollave dhe objekteve fetare, si dhe abrogimin me ligj nga ana e Parlamentit shqiptar të mbajtjes së ferexhesë në publik nga ana e grave myslimane.

1. Le të kujtojmë se e njëjta gjë u përsërit me krijimin e regjencës qeverisëse në kohën e pushtimit gjerman të vendit, sërish të përbërë nga katër përfaqësues të katër besimeve, pa konceptin e shumicës apo pakicës, që mund të sillte pasoja.

Le të kujtojmë se në përgjithësi, zbatimi i këtyre masave, të konceptuara në shërbim të modernizimit dhe oksidentalizimit të vendit, s'hasi në ndonjë rezistencë të fortë, qoftë dhe nga ana e vetë institucioneve fetare.

Po ashtu, vlen të theksohet se gjatë gjithë periudhës së para Luftës së Dytë botërore, në Shqipëri nuk ekzistoi ndonjë parti panislamiste, siç qe, psh. rasti i partisë së aksionit demokratik në Bosnje.

Siç dihet, gjatë periudhës komuniste kjo filozofi e kjo qasje u çua në ekstremin e vet, duke e shpallur fenë armike dhe Shqipërinë, duke nisur që nga mesi i viteve 60-të, vendin e parë plotësisht ateist në botë. Sigurisht që arsyet e këtij eksperimenti ekstrem komunist janë më komplekse, duke nisur që nga fakti që feja gjithsesi përbënte një konkurrencë të padëshirueshme ndaj logjikës totalitare të regjimit. Por, po ashtu, është fakt, që ky eksperiment nuk do të mund të kryhej dot aq lehtë, nëse që më parë s'do ishte rrënjësor thellë bindja e dyshimit ndaj feve në raport me interesat kombëtare.

Arsyeja e kësaj paranteze historike është për të shpjeguar se, në fund të fundit, tek një pjesë e madhe e shqiptarëve është e rrënjësor thellë bindja se laiciteti përbën një ndër shtyllat më të rëndësishme të unitetit e kohezionit kombëtar dhe të jetës së përbashkët të shqiptarëve. Këtë e shprehu më së miri Arbër Xhaferi, kur në kuadër të një polemike, vuri në dukje se për çështjen fetare deri më sot për shqiptarët nuk ekziston alternativë tjetër veç asaj të filozofisë së Rilindjes Kombëtare.

Pavarësisht nga tronditjet e pësura gjatë mëse dy dekadave të fundit që pas rënies së komunizmit, sot Shqipëria vazhdon të konsiderohet si një shembull bashkëjetese dhe mirëkuptimi fetar edhe në këto kohë të trazuara, kur në disa pjesë të botës feja, në vend që të shërbejë për t'i bashkuar njerëzit me mesazhin e saj të paqes dhe të mirëkuptimit, po keqpërdoret për të nxitur urrejtjen dhe dhunën. Në këtë shikim, Shqipëria e fillimit të shekullit të XXI, mund të përcaktohet si një vend laik, ndërkonfesional, që ka si aspiratë të saj kryesore integrimin në Europën e Bashkuar. Paradigma europiane

merr mjaft rëndësi, madje mund të konsiderohet dhe si një ndër faktorët përcaktues në çdo diskutim që lidhet me ardhmërinë e harmonisë fetare në Shqipëri.

Laiciteti (shekullarizmi), pra parimi i ndarjes së qartë të shtetit nga feja, vazhdon të mbetet një ndër parimet kryesore të kushtetutës së Shqipërisë.

E megjithatë, gjatë kësaj periudhe laiciteti dhe shtrirja e tij në jetën publike të vendit e shoqërinë shqiptare në përgjithësi, në një mënyrë a një tjetër janë vënë mësë një herë në qendër të debateve.

Ashtu si dhe në pjesën tjetër të vendeve komuniste të Ballkanit, por në mënyrë mjaft më ekstreme se tjetërkund, për thujse gjysmë shekulli sistemi komunist solli një reduktim të ndjeshëm të rolit që luante feja në shoqëri, duke e shmangur atë thujse tërësisht nga sfera e jetës publike. Me rënien e sistemit komunist s'u krijuan vetëm kushtet për rilindjen dhe konsolidimin e institucioneve fetare në vend. Shembja e sistemit të vjetër bëri të lindin sakaq një sërë debatesh dhe sfidash të reja përsa i takonte marrëdhënieve mes shoqërisë dhe fesë, me fjalë të tjera, për vendin që feja dhe simbolet e saj do duhej të zinin në hapësirën publike shqiptare. Këto debate qenë të zjarrtë që në vitet e para pas rënies së komunizmit kur në vitin 1993, presidenti Sali Berisha mori vendimin për anëtarësimin e Shqipërisë në Konferencën Islamike, çka ngjalli aq shumë debate sa që në fakt marrëveshja edhe pas kaq vjetësh, s'është paraqitur asnjëherë për miratim nga parlamenti. Por fusha kryesore e përplasjes, ku debatet kanë qenë dhe më të pranishme, mbetet ajo e institucioneve të arsimit publik, ku marrin formë bindjet, vlerat dhe besimet e brezave të ardhshëm.

Sidoqoftë, deri më sot, shoqëria shqiptare vazhdon të mbetet një shoqëri ku mbizotëron bindja për domosdoshmërinë e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare, të bazuara në parimin e laicitetit. Por megjithatë, ndoshta pikërisht kjo bindje ka bërë që më së shumti debatet serioze për raportet mes laicitetit dhe fesë të mbeten përgjithësisht periferike.

E megjithatë, një vend si Shqipëria nuk mund t'i shpëtojë

ndikimit të asaj që është duke ndodhur përreth, ku faktori fetar është duke u shfaqur gjithnjë e më shumë si një faktor mobilizimi kolektiv dhe identifikimi e rrjedhimisht, si një burim e njëherësh legjitimim konfliktesh. Nga ana tjetër, në thelbin e tij fenomeni i globalizimit sfidon vetë konceptin e shtetit-komb, pra përbën një kuadër funksionimi dhe identifikimi që paradoksalisht sjell përforsimin e identiteteve të ndryshme fetare, duke sjellë vetiu konfiguracione të reja në raportet mes fesë dhe kombit (identitetit). Ndërkohë, kur flasim për ndikimin e globalizimit e pasojat që mund të ketë në vende të tilla si Shqipëria, mendoj se nevojitet të bëhet një sqarim. Ndryshe nga përfytyrimi që ekziston përgjithësisht kur bëhet fjalë për globalizimin, ndikimi i tij s'është vetëm në njërin kah, pra s'është vetëm nga Perëndimi në drejtim të pjesës tjetër të botës. Në një pjesë të botës, ku përfshihet dhe një pjesë të Europës Juglindore pjesë e globalizimit janë dhe përpjekjet e gjithë kësaj dekade të fundit të Arabisë Saudite dhe disa vendeve të tjera të Gjirit, apo dhe Turqia për të eksportuar një model, që, përmes faktorit fetar, kërkon padyshim, të sjellë dhe një model kulturor dhe, pse jo, politik.

Në këtë shikim, në vende si Shqipëria, por dhe më gjerë në një pjesë të vendeve të tjera paskomuniste të Ballkanit, çdo diskutim që bëhet për fenë dhe vendin e saj në shoqëri, s'mund të ndahet dot nga diskutim tjetër që dominon faktikisht diskurin publik prej një dekade e këtej mbizotëron diskurin publik në këto vende: ai për trinomin modernitet, oksidentalizim (europianizim), globalizim. Diskutim ky që, në fund të fundit, ka të bëjë drejtpërdrejt me modelin e modernizimit që aspiron të adaptojë një vend i caktuar.

SHTYPI SHQIPTAR PËR RAPORTET
MES FESË, LAICITETIT DHE
HAPËSIRËS PUBLIKE

SHTATOR 2011-QERSHOR 2012

Gjatë periudhës së shqyrtuar, debati kryesor në faqet e shtypit shqiptar për sa i takon raporteve mes fesë dhe hapësirës publike, lidhet sërish me laicitetin e shkollës. E reja kësaj here është se debati që përsëritet tashmë prej vjetësh për pranimin ose jo të simboleve fetare në shkollat publike, i është shtuar dhe debati për përfshirjen ose jo të edukatës fetare në shkollat publike. Debatin kësaj here e ka nxitur paraqitja e projektligjit të ri për arsimin parauniversitar nga ana e Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë.

Është me vend të kujtojmë se vetëm para disa muajsh i njëjti propozim u bë dhe në Kosovë, në formën e disa amendimeve për ligjin për arsimin, duke ngjallur dhe aty një debat të zjarrtë. Siç dihet, propozimi u hodh poshtë nga ana e Parlamentit të Kosovës.

Për të patur një panoramë deri diku të plotë të këtij debati, na ndihmon gazetarja e gazetës **Mapo, Jonida Tashi**, e cila i kushton kësaj teme dy shkrime të saj (**Gazeta Mapo, 27 prill 2012**), ku evidentohen qartazi argumentat e atyre që janë në favor të një shkolle publike të hapur ndaj simboleve fetare dhe të edukimit fetar dhe të atyre që janë kundër, duke këmbëngulur te ruajtja e karakterit laik të arsimit publik. Duhet thënë se, në këtë rast, ravijëzohet një kundërvënie e qartë mes qëndrimit të Ministrisë së Arsimit (ku është interesante të vërehet mënyra sesi e interpreton ajo karakterin laik të shkollës në Shqipëri) dhe opozitës socialiste, e cila është tërësisht kundër çdo lloj përfshirjeje të elementëve fetarë në arsimin publik.

Në shkrimin e saj "**Lëndë fetare në shkolla, Tafaj pranon kërkesën e klerikëve.**", **J.Tashi** shkruan: "*Propozimi i bërë njëzëri nga pesë komunitetet fetare në vend për futjen e një lënde religjioze në shkollat e arsimit parauniversitar ka sjellë përplasjet e para në radhët e specialistëve dhe politikanëve. Ndonëse për momentin propozimi është thjesht një ide që kërkon kohë për t'u zbatuar në praktikë, ai është mbështetur nga kreu i Ministrisë së Arsimit, Myqerem Tafaj, i cili ka deklaruar dje se është e rëndësishme që nxënësit të marrin edhe njohuri për fenë. Është e rëndësishme, mendoj unë, që nxënësit të marrin njohuritë për fenë.*

.... Përvoja e mjaft vendeve të tjera është e tillë, që një lëndë e tillë është në grupin e lëndëve me zgjedhje, – deklaroi ministri Tafaj. Por, një qëndrim krejt të kundërt me të ka ish-ministri i Arsimit, Et'hem Ruka, njëherësh edhe kreu i komisionit kuvendor të Shëndetësisë, Punës dhe Çështjeve Sociale, sipas të cilit, kërkesa e klerikëve, por dhe qëndrimi i ministrit janë antikushtetues. 'Kushtetuta e Shqipërisë nuk e lejon një gjë të tillë. Shkolla ka karakter laik dhe laik do të thotë që nuk mund të zhvillohen mësimet fetare në shkolla. Ka institucione të tjera ku mund ta shprehin identitetin e tyre fetar', – u shpreh Ruka. Ndërkohë që edhe më i ashpër është mendimi i historianit Pëllumb Xhufi. Duke u bërë apel klerikëve të distancohen nga veprime të tilla, Xhufi deklaroi se hyrja e fesë në shkolla do të vinte në rrezik shtetin shqiptar, i cili ndër shekuj ka qenë i ndarë dhe i pavarur nga feja. 'Po të mos jetë laik shteti shqiptar, sigurisht do të mund të krijoheshin probleme të cilat na drithërojnë dhe na trembin kur shohim se ç'ndodh sot në Liban. Ta kthesh edhe shkollën në parcelizim shpirtëror, atëherë kjo mua më duket krejtësisht e papranueshme. Është antikushtetuese, antihistorike. Do kisha kërkesë nga ana ime që t'i kthehen vetes në radhë të parë dhe mundësisht të ngatërrohen sa më pak ose hiç fare, siç i mëson Bibla dhe Kurani, me politikë', – pohon historiani. Nga ana tjetër përfaqësues të Ministrisë së Arsimit shpjegojnë se lënda fetare në shkolla është thjesht një ide e komuniteteve që, nëse pranohet, kërkon ndryshimin e kurrikulave shkollorë për t'u bërë pjesë e lëndëve që nxënësit do të mësojnë me dëshirë në shkollë..." (Gazeta Mapo, 27 prill 2012)

Në një tjetër shkrim, në po të njëjtin numër të gazetës, e njëjta autore e zgjeron vështrimin përsa i takon debatit për laicitetin e shkollës: "Debati për lëndët fetare në shkolla, Myslimanët: Të lejohet edhe shami" (Jonida Tashi, Mapo, 27 prill 2012)

"Diskutimi i ligjit të ri për arsimin parauniversitar", shkruan ajo, "ka risjellë në qendër të vëmendjes debatin për ndalimin e simboleve fetare në shkolla, sikundër janë edhe shami. Përfaqësues të pesë komuniteteve fetare në vend, të pranishëm në mbledhjen e djeshme të Komisionit të Edukimit, ku po shqyrtohet ky projektligj, kërkuan që simbolet e feve të lejohen edhe në shkollat publike. Ashtu sikurse pritej, qëndrimin

më këmbëngulës për këtë çështje e përcollën përfaqësues të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH), nënkryetari i të cilit, Bujar Spahiu, deklaroi se asnjë nxënës nuk duhet të privohet nga e drejta për t'u arsimuar në shkollat publike për shkak të simboleve fetare. ... Duke rënë dakord për moslejimin e indoktrinimit fetar në shkolla, nënkryetari i komunitetit fetar më të madh në vend propozoi futjen e një lënde për njohuritë fetare në arsimin e mesëm. 'Asnjë nxënës nuk i lejohet të propagandojë dhe të shpjegojë me të tjerët, por kemi theksuar që në bazë të ligjeve tona në fuqi dhe konventave ndërkombëtare, qofshin ato të Bashkimit Europian, qofshin ato të Kombeve të Bashkuara, që asnjë nxënës në botë, as gjinia, as raca, as feja nuk i ndalohet që të shkollohet edhe në ato publike. Një lëndë që mund të futet në të ardhmen kur të formohen kushtet, që të gjithë nxënësit, jo vetëm ata në privat, që mund të marrin diçka nga feja, por edhe ata që vazhdojnë edukimin e tyre në shkollat publike të dinë se kush janë, pse kanë ardhur dhe çfarë kërkohet prej tyre, në mënyrë përmbledhëse një kulturë fetare' – tha Spahiu. Kërkesa e myslimanëve për lejimin e simboleve fetare në arsimin parauniversitar është kundërshtuar nga kryetarja e Komisionit të Edukimit, njëherësh deputete e Partisë Socialiste, Valentina Leskaj, e cila megjithëse ka deklaruar se propozimet e komuniteteve fetare do të shqyrtohen nga komisioni, ka pasur qëndrim të prerë për këtë çështje. ... Drafti "Për arsimin parauniversitar" ndodhet prej më shumë se një jave në komisionet parlamentare. Deri tani ai është kaluar me shumicë votash vetëm nga Komisioni për Integrimin Europian, anëtarët e të cilit e kanë shqyrtuar projektligjin nga pikëpamja e përshtatjes me legjislacionin europian në sektorin e arsimit dhe edukimit, si dhe me konventat përkatëse në fuqi. Pas seancave dëgjimore në të gjitha komisionet kuvendore, drafti do t'i nënshtrohet shqyrtimit nen për nen, për të shkuar më pas për miratim në seancë plenare." (Gazeta Mapo, 27 prill 2012)

Duhet thënë se ky debat pati një mbulim të gjerë dhe nga media elektronike, e cila në kronikat e saj u përqendrua sidomos tek mbështetja nga ana e Ministrisë të Arsimit, z. Eqrem Tafaj, të futjes së edukimit fetar në shkollat publike, si dhe te kundërshtimi që kryetarja e Komisionit Parlamentar për Arsimin, Kulturën dhe

Median, znj. Valentina Leskaj, i kishte bërë këtij propozimi. Shtypi citon me këtë rast gjerësisht reagimin e znj. Leskaj: *“Arsimi jo vetëm që duhet të mbetet laik, por në radhë të parë duhet të kemi parasysh që flasim për një kategori arsimit, siç është arsimit parauniversitar që ka të bëjë me një grupmoshë, që nuk është në zotësi për të marrë vetë vendime të pavarura. Pra, këtu përfshihet që nga kopshti, deri tek arsimit i mesëm i lartë. Do të thotë që kemi të bëjmë me një kategori fëmijësh, të cilët nuk zgjedhin dhe nuk vendosin dot vetë për sa i përket vendimmarrjes. Edhe në raportet me simbolet që u diskutua këtu, duhet të kemi parasysh laicitetin e shkollës”* citohet të ketë thënë znj. Leskaj. (**Top Channel, lajmet kryesore të datës 27 prill 2012**)

Sidoqoftë, duhet shtuar se një pjesë e shtypit s’i kushtoi ndonjë vëmendje të veçantë këtij debati, siç ndodh shpesh kur vjen puna te mbulimi i temave që lidhen me fenë. Gazeta Mapo përbën këtu një përjashtim, duke i kushtuar këtij debati një vend të dukshëm. Në faqet e saj i lihet vend si mendimeve në mbështetje të projektligjit të qeverisë, ashtu dhe atyre kundër tij.

Kështu, në mbrojtje të përfshirjes së edukimit fetar në arsimin publik shprehet një shkrim me autor Fabian Zhillën: **“Arsimi parauniversitar midis laicizmit politik dhe multikulturalizmit”** (**Gazeta Mapo, 28 prill 2012**). Sipas autorit, *“kjo iniciativë ligjore ka risjellë për të disatën herë, diçka që tani duket të jetë kthyer thuhet në diskutim kronik - ndarja e kufijve midis fesë dhe shtetit. Sipas pikës 4 të nenit 36 të këtij projektligji, në institucionet arsimore parauniversitare, do të ndalohet ekspozimi i simboleve fetare..., përveçse në shkollat ku mësohen lëndë fetare”*. *“Vetë projektligji, komenton autori i shkrimit, - nuk bën një përcaktim se çfarë ka parasysh ligjvënësi me simbol fetar, duke e lënë interpretimin e tij shumë evaziv dhe me mundësi të larta abuzimi.”* Autori citon fjalët e ministrit Tafaj në emisionin **‘Studio e Hapur’** në televizionin **ALSAT të 12 dhjetor 2010**, pra të para dy vjetëve, kur ky paska thënë se *‘simbolet [fetare] kanë të bëjnë natyrisht me mjedisin, por kur bëhet fjalë për personin atëherë ligji parashikon një rregullore në shkollë dhe kjo rregullore të jetë e zbatueshme nga të gjithë’*. Duke pranuar se në thelb të debatit janë *‘marrëdhëniet midis institucioneve*

publike dhe simboleve fetare, ai mendon se ndalimi i simboleve fetare në shkolla është diçka që bie ndesh “*me trendin kulturor global*.”, duke qenë i ndërtuar “*mbi baza përjashtuese dhe dalluese. Pra, nxënësi shqiptar, megjithëse të nesërmen do të jetë një shtetas evropian i cili mund të ndajë jetën, profesionin apo shumëçka me dikë tjetër (feje, ideologjie, ngjyre), do duhet që në gjenezë të edukimit të tij të sintetizojë botëkuptimin mbi ndasitë/segregimin dhe jo respektimin e të ndryshmes*.” Më në fund, Zhilla, arrin në përfundimin se problemi qëndron në vetë konceptin mbizotërues në Shqipëri përse i takon laicitetit. “*Fatkeqësisht, shkruan ai, ndjehet një nervozizëm në mjediset intelektuale të cilët e shohin laicitetin si antitezë të fetares. Është shumë e paqartë dhe jo konstruktive mënyra sesi artikuloohen nocionet e laicizimit në Shqipëri*.”

Një vështrim mjaft më kompleks për këtë çështje na sjell filozofi Artan Fuga në shkrimin e tij të titulluar “**Laiciteti i shkollës – parakusht për bashkëjetesën fetare**”. I botuar në fakt, disa muaj para se në projektligj të qe futur neni për arsimin fetar (**Gazeta Mapo, 27 dhjetor 2011**), Fuga shprehet në përgjithësi pozitivisht për projektligjin në fjalë, i cili sipas Artan Fugës “... ka një sërë normash, të cilat e përmirësojnë ndjeshëm kuadrin ligjor të tanishëm, në përputhje me kushtet e reja të zhvilluara që ai kryhet.” A. Fuga ndalon më konkretisht në një ndër pikat më të nxehta të diskutimit, që ka të bëjë me ndalimin ose jo të ekspozimit të simboleve fetare në institucionet arsimore. Artan Fuga merret sidomos me përkufizimin se ç’duhet kuptuar me konceptin ‘aktorët e interesuar’ të përmendur nga ana e Ministrisë, kur bëhet fjalë për një debat të tillë: “... ka vend të mbahet parasysh se cilët janë aktorët e interesit që duhen konsultuar për këtë çështje? Sepse deri më tani kritikët e kësaj dispozite kanë lënë disi mënjane aktorin thelbësor të interesit. Përmenden komunitetet fetare. Sigurisht. Drejtoritë e institucioneve arsimore. Sigurisht, edhe ato. Mësuesit. Patjetër. Por, harrohet deri tani të theksohet se aktori themeltar i interesit janë në radhë të parë prindërit. Asnjëri nga aktorët e më parë përmendur nuk mund të barabitet me statusin e familjes dhe të prindit që është përgjegjës ligjor dhe moral prioritar për edukimin e fëmijëve të

tij. Askush nga institucionet e tjera nuk mund të barabitet me familjen. Fjala e prindërve është vendimtare si aktor interesi.” na kujton ai.

Më poshtë në shkrimin e tij Fuga sqaron se “... autori i këtyre radhëve, i cili, kur ishte rasti i përjashtimit të disa vajzave nga një universitet publik disa vite më parë, sepse mbanin shami në kokë, është shprehur kundër kësaj mase në publik. Atëherë, përse në atë kohë u mbajt ai qëndrim, e tani jo më i njëjti pozicion?... Përgjigjja është e thjeshtë dhe e ndershme: Sepse atëherë bëhej fjalë për të reja që ishin në moshën e pjekurisë dhe që me ndërgjegje të lirë mund të vendosnin për t'i mbajtur apo jo shamitë e tyre mbi kokë. Për ato mosha çështja shtrohet ndryshe. Duhet me qenë tolerantë, nëse nuk ka imponim ose dhunim nga të tretë.”

Fuga shpreh mendimin e tij dhe për akuzën e dëgjuar shpesh se masa të tilla janë të drejtuara kryesisht kundër besimit mysliman. “Disa shkuan menjëherë drejt fesë islame, - komenton ai, - sikur dispozita të mos mbështetej në respektin e barazisë të të gjitha feve. Kjo dispozitë është për respektimin e laicitetit në një hapësirë laike sikurse është shkolla dhe nuk drejtohet aspak kundër kësaj apo asaj simbolike fetare. Menjëherë shkoi fjala e shpejt te shamia mbi kokë. Por, edhe këtu më duket se ka stereotipa që shkojnë padrejtësisht në dëm të fesë islame, si pjesë e kulturës fetare të një pjese të opinionit, dhe që si e tillë meriton pa fjalë respektin e gjithkujt, sikurse edhe besimet e tjera fetare. Por, edhe një herë tjetër duhet theksuar se bëhet fjalë për vajza që gjatë kësaj faze arsimimi janë ende fëmijë, adoleshente dhe vetëm në dy a tre vitet e fundit janë të reja në një farë moshe. Janë ato përherë të lira të vendosin vetë nëse duan apo nuk duan ta mbajnë atë veshje?... Dispozita që ndalon ekspozimin e simboleve fetare në sistemin e arsimit parauniversitar (nuk është fjala për universitetet), a nuk ndihmon që në shkollat tona fëmijët të rriten me idenë e të qenit pjesë e një opinionit të tërë, të përbashkët publik? A nuk eliminon rrezikun e moskuptimeve që vogëlushët ose adoleshentët mund t'i çonte edhe në tensione apo debate që nuk janë fort të dobishme për moshën e tyre? A nuk i afron ata më shumë me njëri-tjetrin në mënyrë që të mos ketë barriera, që në atë moshë mund të rrënjosen në psikozat fëmijërore aq të paadministrueshme?” Artan Fuga nënvizon faktin e rëndësishëm që, në fakt, përmbledh shqetësimin dhe frikën e shumë prej atyre që

i tremben çdo ndërhyrjeje në laicitetin e shkollës: “Këta shkollarë, të edukuar në mjediset e shkollës si hapësirë laike, nuk do të ndahen brenda saj nga kufij simbolikë fetarë. Se po qe se ndodh e kundërta, atëherë ku është vlera e asaj që shkolla është një hapësirë laike fetare? ...Një laicizëm në fëmijëri, rrënjosur përgjatë jetës në shkollë, mund të jetë një element thelbësor për tolerancë dhe bashkëjetesë fetare për ata që do të rriten. Për të ardhmen.” Dhe në fund, ai shtron pyetjen: “A nuk ka qenë kështu deri tani? Përse të luajmë duke bërë eksperimente të kota?”

Të një mendimi të kundërt me atë të Artan Fugës janë dy emra sërish të njohur të gazetarisë. I pari **Endri Xhafo**, në shkrimin e tij “**Çfarë e ndalon shaminë në shkolla?**” (**Gazeta Shqip – 22 nëntor 2011**), e vë theksin te vetë domethënia e konceptit të laicitetit, duke e venë në dyshim që ai të nënkuptojë ndalimin e simboleve fetare në shkolla:

“Laiciteti i shtetit nënkupton ndarjen e shtetit nga feja, dhe për rrjedhojë, mosadoptimin e një feje zyrtare; zbatimin e ligjeve civile nga gjykata civile; lejimin e divorcit (aborti nga ana e tij i nënshtrohet një diskutimi sa fetar aq edhe etiko-profesional nga mjekësia) dhe në fund, sigurisht mësimdhënia.” shkruan ai, duke vazhduar: “Në një vend si Shqipëria, ku feja nuk ka luajtur rol në formëzimin e identitetit kombëtar, përkundrazi, ‘feja e shqiptarit... [ka qenë] shqiptaria’, laiciteti duhet ruajtur me po atë kujdes që përpiquej ta injektonte Vaso Pasha në vitin 1880. ... Laiciteti në Shqipëri merr edhe vlerën e garantit të harmonisë fetare. Por projektligji i ri për arsimin në një pikë të tij, duket se rrezikon pikërisht këtë harmoni. Komuniteti që mund të lëndohet në mënyrë më të drejtpërdrejtë është komuniteti mysliman, sepse ndalimi i shenjave fetare mund të shënjestrojë më së shumti shaminë myslimane, si shenja e jashtme më e dukshme e përkatësisë fetare.” Sipas E. Xhafos, “Shamia apo kryqi si stoli nuk e cenonë thelbin laik të shkollës. Nëse nxënësit do të ndaloheshin me ligj për t’i mbajtur këto, sikurse e kërkon një rrymë e opinionit publik, kjo do të cenonte në radhë të parë të drejtën kushtetuese për besimin fetar (Kushtetuta, neni 24.1) dhe do të përbënte një diskriminim për shkak të besimit apo të shprehjes së besimit, që ndalohet si nga Kushtetuta (neni 18.2), nga ligji për mbrojtjen nga diskriminimi (neni 10.1), por edhe

nga vetë projektligji për arsimin (neni 6.2). Këtë kontradiktë, projektligji duhet ta zgjidhë në favor të lirive individuale.” Sipas E. Xhafos: “Laiciteti i shkollës, ... qëndron te mësimdhënia dhe ambientet e përbashkëta, që administrohen nga shteti. ... E vërteta, që nuk na pëlqen ta themi me zë të lartë, është se ndalimi i ‘shenjave fetare’ shënjestron më së shumti myslimanët. Bezdia që një pjesë e opinionit publik ndjen prej besimtarëve praktikantë, lidhet pikërisht me aspektin e jashtëm të djemve me mjekër e pantallona treçerekëshe dhe të vajzave me shami në kokë. Për shumëkënd islami jo vetëm është demode, por nuk është as besimi origjinal i shqiptarëve. Mendohet se ai bie ndesh me aspiratën europiane të popullit shqiptar, në rrugëtimin e tij drejt një Europe të ngritur mbi trashëgiminë kulturore judeo-kristiane. Reagimi i asaj rryme që është kundër mbajtjes së shenjave fetare në shkolla, e ka origjinën pikërisht në këtë pavetëdije kolektive, të përzier me objektivitetin historik. Po ashtu, ekziston një amalgamë ‘islami/ botë arabe’, që qëndron varur si një rrezik i përhershëm, sa kohë formimi i kuadrove fetare vazhdon të bëhet në vende me islam radikal si Arabia Saudite. Ndaj, edhe në këtë pikë, flladi që fryn nga shkretëtirat arabike rrezikon të acarojë racizmin anti-islam.”

Pak a shumë në të njëjtën linjë mendimi është dhe një emër tjetër me ndikim në median shqiptare, Blendi Kajsio. Në shkrimin e tij **“Ferexheja e Islamofobisë”** (Gazeta Panorama 27 prill 2012), ai mendon se justifikimi që jepet për përjashtimin arbitrar nga shkolla i vajzave myslimane që mbulojnë kokën me shami, me argumentin *“se shkolla shqiptare është laike është qesharak pasi laiciteti i shkollës do të thotë që programi mësimor është jo-fetar dhe jo se studentët duhet të jenë të tillë. Përndryshe i bie që sistemi ynë shkollor të jetë vetëm për studentët jo-fetarë. Ose për ata studentë që e përqafojnë fenë ‘part-time’, pra janë fetar në shtëpi por jo në shkollë. Paradoksalisht kjo logjikë i përjashton studentët fetar nga sistemi publik i arsimit, duke i detyruar ata të shkollohen vetëm në shkollat fetare. Kemi të bëjmë me një logjikë që në dukje nisët nga dëshira për të ruajtur laicitetin e edukimit publik dhe në realitet përfundon tek promovimi i shkollave fetare.”*

Sipas tij: *“... përjashtimi nga shkolla i të rinjve apo të rejave, që*

kanë përqafuar islamin më shumë sesa nga dashuria për arsimin publik motivohet nga frika ndaj Islamit.”

Më poshtë, po sjellim dhe disa shkrime të tjerë në të njëjtën linjë, ç’është e vërteta të botuar në botime mjaft më periferike, si ai me autor **Jordan Dacin**, “**E drejta e Lirisë së Besimit dhe laiciteti i Universiteteve**”, (marrë nga “**Studenti i së drejtës**”, botuar pjesërisht dhe në **gazetën Shqip, 23 mars 2012**), i cili përqendrohet kryesisht në argumentet ligjore që, sipas autorit, bien ndesh me “*pengimin e besimtarëve mysliman për të mbajtur veshjet e tyre*”.

Po ashtu, shkrimi “**Arkaizmi i laicitetit**” me autor **Xhemis Stafën** (**Gazeta Sot – 29 shtator 2011**).

Me tone mjaft më agresive janë një sërë shkrimesh të përfaqësuesve të komunitetit mysliman që e ndejnë veten të prekur nga këto masa, sipas tyre, diskriminuese. Shkrime të tillë janë të shumtë sidomos në faqen apo blogjet on-line islamike, duke qenë se ato rrallë arrijnë të botohen në median kryesor. Ja disa shembuj prej tyre:

Kështu në datën **25 prill 2012**, faqja on-line ‘**Bota Islame**’, ashtu dhe ajo ‘**E –zani i naltë**’, botojnë shkrimin “**Klerikët njëzëri: Të lejohen simbolet fetare në shkolla**”, ku përqendrohen tek presioni i ushtruar nga ana e komuniteteve fetare që kërkojnë “*lejimin e simboleve fetare në shkollat publike, por edhe futjen e një lëndë edukative në kurrikulat e mësimi*.” Shkrimi raporton ato që përfaqësuesit e bashkësive fetare thanë në mbledhjen e Komisionit Parlamentar gjatë diskutimit të projektligjit për arsimin parauniversitar të paraqitur nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Ky raportim shoqërohet nga një shkrim me autore **Loela Xhafën**, me titull “**Laicizmi Përjashtues i Politikave Post-Komuniste**” (**12 maj 2012**), ku akuzohet zonja Valentina Leskaj se në kundërshtimin e saj ndaj projektligjit të Ministrisë niset nga “premise ateiste”. Sipas autores, qëndrime të tilla si ato të zonjës Leskaj nisen “*nga premisa tashmë trend e islamofobisë*”. Sidoqoftë, autorja shkon dhe më larg, kur përfundon se “*... mësimi i lëndëve fetare në shkolla ... do të shembte zhurmshtëm ngrehinën e kalbur të gënjeshtreve, që vazhdojnë të*

përçudnojnë mendjet e nxënësve dhe të rinjve në tekstet aktuale të shumë lëndëve shoqërore në shkollat tona.”

Të njëjtën temë mbulon dhe shkrimi i gazetës **Koha Jonë (27 prill 2012)** me autore **Luljeta Ndokën**, të titulluar, **“Shamia jo simbol, por detyrim kuranor”** dhe nëntitull **“Lëndë fetare në shkolla, Tafaj pranon kërkesën e klerikëve.”**

Sipas artikullit, *“Për herë të parë, 71 drejtues të xhamive të vendit, kanë reaguar publikisht duke deklaruar se projektligji për Arsimin Parauniversitar cenon të drejtën e shkollimit, por edhe tolerancën fetare.”* Për këtë, njofton shkrimi *“Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Haxhi Selim Muça është pritur dje në një takim të veçantë nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj. Muça i ka përcjellë Ministrin Tafaj, shqetësimin e besimtarëve myslimanë në mbarë vendin në lidhje me këtë projektligj, ku veçanërisht pika 4 e nenit 36 ka ngjallur debate të shumta, lidhur me kuptimin dhe interpretimin e saj. “Kjo pikë është interpretuar dhe po vazhdon të interpretohet si masë ndaluese, veçanërisht për mbajtjen e shamisë-mbulesë e kokës (flokëve) të vajzave myslimane, gjatë frekuentimit të institucioneve arsimore publike dhe private në Republikën e Shqipërisë”, tha Muça. Ai e ka sqaruar ministrin Tafaj se mbulesa e flokëve nuk është një simbol fetar, por është praktikë fetare dhe është një urdhëresë Kur’anore e detyrueshme për të gjitha vajzat që kanë mbushur moshën e pjekurisë.”* Sipas shkrimit, *“Nga ana e tij, ministri Tafaj e ka garantuar kryetarin e KMSH-së se nuk do të ndërmerret asnjë nismë zyrtare për miratimin e projektligjit në fjalë, pa u marrë në konsideratë sugjerimet e grupeve të interesit. Ai u shpreh se, projektligji është në diskutim publik dhe nuk është përfundimtar. Ligji nuk mund dhe nuk do të bjerë ndesh me Kushtetutën e vendit dhe me ligjin e mosdiskriminimit. Ky projektligj në variantin e tij final do të jetë gjithashtu në përputhje të plotë me sugjerimet e Bashkimit Evropian. Gatishmëria e MASH është maksimale për të konkluduar çdo gjë me gjuhën e mirëkuptimit”, u shpreh ai.”*

Le ta mbyllim këtë kapitull me një shkrim që plotëson panoramën e arsimit shqiptar. Shkrimi titullohet: **“Studimi, në Shqipëri ka 580 shkolla jopublike”**, shkruar nga **Ola Mitre (GazetaShqiptare/**

BalkanWeb, 11 maj 2012). Në të përmendet një hulumtim i bërë nga “Open Data Albania”, sipas të cilit në vendin tonë funksionojnë 580 institucione arsimore jopublike të sistemit parauniversitar, ndërkohë që 14 prej tyre janë shkolla fetare.

“Kjo përbën edhe 2.41 për qind të totalit të tyre, shifër kjo relativisht e lartë. Hulumtimi u shtri mbi numrin dhe vendosjen gjeografike të shkollave jopublike, të cilat funksionojnë sipas miratimit të Këshillit të Ministrave. Në total, për vitin shkollor 2011-2012, në vend funksionojnë 580 institucione arsimore jopublike të sistemit parauniversitar miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), Urdhër të ministrit të Arsimit ose akt të Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL). Në tërësinë e institucioneve arsimore jopublike parauniversitare janë 14 institucione fetare të sistemit parauniversitar. Këto institucione arsimore jopublike parauniversitare janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave”, - thuhet në publikimin e bërë në faqen zyrtare të “Open Data Albania”. “Shkollat janë të vendosura në qytetet kryesore si: Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Berat dhe Kavajë. Numrin më të madh e mban qyteti i Durrësit me tre shkolla, ndërsa në qytetet e tjera numërohen nga dy shkolla, përkatësisht në qytetet e: Tiranës, Korçës, Shkodrës, Elbasanit, Kavajës dhe Gjirokastrës. Vendin e fundit e zë qyteti i Beratit me vetëm një shkollë jopublike me karakter fetar. Para disa ditësh në Komisionin Parlamentar të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, u hodh ideja që edhe në shkollat publike të futet një lëndë me karakter fetar, ndërkohë që nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës u gjet mbështetje në lidhje me këtë çështje.”

Censusi i popullsisë dhe përkatësia fetare

Gjatë kësaj periudhe, një vend të dukshëm në një pjesë të shtypit të shkruar e zuri diskutimi për rezultatet e censurit të fundit të popullsisë ku, siç dihet, për herë të parë pas më se gjysmë shekulli, kërkohet të nxirret përkatësia fetare dhe etnike e shqiptarëve. Ndonëse ende jo të publikuara zyrtarisht, sipas disa prej organeve të shtypit, duket

lajm i konfirmuar se 70% e shqiptarëve s'kanë pranuar të deklarojnë besimin e tyre fetar.

Kësaj teme i kushton një vend të gjerë gazeta **Shekulli e datës 25 prill 2012**, në një editorial të gjatë të titulluar “**Censusi përmbys fetë – 70 përqind refuzojnë ose nuk deklarojnë besimin**”, ajo parashikon se cilat mund të jenë disa prej implikimeve të mundshme të këtij censusi. Më poshtë po japim pjesë të zgjeruara prej tij.

Sipas editorialit të Shekullit, mospublikimi i rezultateve të Censurit 2011 në Shqipëri, “... *nuk mund të fshehë më ndryshimin e ndodhur brenda popullsisë shqiptare e cila në vitin 2011 edhe numerikisht ka ndryshuar duke shkuar në 2,831,741 banorë.*” Përpos kësaj, sipas autorit të editorialit (**Skerdilaid Zaimi**), “*ajo paraqitet me një tipologji të re identitare sidomos sa i përket hartës fetare. Kështu, burime nga INSTAT-i bëjnë të ditur se në procesin e deklarimit fetar raporti i dikurshëm i sanksionuar mes dy besimeve kryesore fetare në Shqipëri mund të pësojë rrëshqitje.*”

Sipas tij, “*Arsye për këtë është jo dhe aq lindja e neofitëve apo konvertimi mes besimtarëve, sesa mosdeklarimi i qytetarëve. Shifra 70%, e përmendur më herët në media, që sugjeron numrin e të regjistruarve që nuk janë shprehur për besimin, rezulton përfaqësisht e vërtetë edhe sipas burimeve nga INSTAT. Duke mos marrë në konsideratë faktin se rreth 1 milionë emigrantë nuk janë bërë pjesë e censurit, atëherë ndërtimi i fytyrës së re fetare të shqiptarëve pritet të jetë befasues. Për krahasim, në një sondazh të kryer që në vitin 2001 në këtë drejtim, solli në vëmendje shifrën se të paktën mbi 10% e qytetarëve deklarorin se nuk i përkisnin asnjë besimi. E marrë gjithsesi me rezervë ajo sinjalizon se një proces tjetërsimi është në zhvillim edhe pse besimi fetar perceptohet nga një pjesë e popullsisë si përkatësi për shkak të familjes dhe jo si çështje besimi.*”

Siç dihet, të dhënat e fundit zyrtare përsa i takon përkatësisë fetare të shqiptarëve deri më sot konsiderohen ato të censurit të fundit të viteve 1930-t, të shekullit të shkuar, sipas së cilave 70% e shqiptarëve qenë të besimit myslimanë, 20% ortodoksë dhe 10% katolikë. Sipas editorialit të **gazetës Shekulli**, “*kjo shifër e regjistruar në censusin e vitit 1930 pret tanimë të konfirmohet ose të përgënjeshtrohet. Në këtë proces*

delikat, INSTAT ka zbatuar parimin e vetëdeklarimit të qytetarit, ndonëse shprehja e besimit është çështje private.”

Në shkrim vihet në dukje dhe një fakt, që në një të ardhme mund të sjellë diskutime, i cili ka të bëjë me faktin se nga censusi u përjashtuan shqiptarët me banim jashtë vendit në çastin e regjistrimit. Sipas autorit të shkrimit, *“me gjasë kriteri i regjistrimit sipas kohës së banimit në Shqipëri prek më shumë komunitetin ortodoks, pasi një shumicë emigrantësh janë të këtij komuniteti.”* Sidoqoftë, sipas Shekullit, *“... është e qartë se prej vitit 1930 e deri më sot, në Shqipëri, një vend që përjetoi ndalimin e besimit fetar për një brez të tërë, ka rrjedhur shumë ujë dhe për këtë arsye rezultati i INSTAT-it mbetet të provojë nëse lufta bëhet për ringjalljen shpirtërore sikundër shprehet shpesh kryeministri aktual, apo për statistikën.”*

Më tej, editoriali ngre një sërë çështjes të tjera që lidhen me implikimet që mund të ketë rezultati i këtij censusi. Sipas tij, një implikim që lidhet me fenë, që mund të sjellë rezultati i këtij censusi, ka të bëjë me anëtarësinë e Shqipërisë në Konferencën Islamike: *“Në Shqipëri ka zyrtarisht 4 komunitete fetare të njohura tradicionalisht që rrjedhin nga dy besime-mysliman dhe kristian. Komuniteti mysliman ndahet në sunit dhe bektashi, ndërsa ai kristian në ortodoks dhe katolik. Këto muajt e fundit, Shqipëria ka njohur zyrtarisht edhe komunitetet Protestan, një risi kjo që duhet thënë se gjen pika takimi edhe me historinë e Rilindjes. Në të gjithë këtë hartë fetare, konkurrenca për besimtarë është historike dhe aktuale. Historike pse ajo dikur u sfidua me kredon e Vaso Pashës e më vonë nga regjimi komunist, por aktuale për shkak të përparimit të institucioneve fetare thujse ngado. Lëvizja e shifrës së besimit mbetet me rëndësi parësore, pasi përcakton ndryshime thelbësore gjeopolitike. Kështu, në respekt të shifrës tradicionale, Shqipëria është anëtare me të drejta të plota e Konferencës Islamike, ndërkohë që një rrjedhje eventuale nga shumica dominuese myslimane, mund të shtronte pikëpyetje mbi angazhimin politik në fjalë.”* shkruhet në të.

Një shkrim tjetër i nënshkruar nga një emër i njohur i gazetarisë, që i kushtohet po këtij problemi, është ai i **Mustafa Nanos**, me titull: **“Pse INSTAT-i na fsheh të dhënat e censunit? (Gazeta Shqip, 19**

qershor 2012). Pasi komenton faktin se sipas tij, INSTAT është një institucion totalisht i kontrolluar prej kryeministrit të vendit, Nano hedh dyshime për arsyen përse dhe gati një vit pas kryerjes së tij, deri më sot janë dhënë fare pak të dhëna për rezultatet e censusit të kryer. Sipas M. Nanos, arsyeja përse ky institucion s'po jep ende rezultatin e plotë të censusit, ka shumë të ngjatë të jetë fakti që kryeministrit të vendit, z.Berisha, s'i pëlqen rezultati që ka dalë. *“Censusi ka mbi tetë muaj që është kryer, - shkruan M. Nano – “dhe qysh përpara se të fillonin procedurat e regjistrimit ka pasur një kureshtje lidhur me hartën fetare e etnike të popullsisë në Republikën e Shqipërisë. Kjo kureshtje vjen edhe për shkak të faktit që një regjistrim i tillë kish dekada që nuk bëhej; dhe nuk janë dekada dosido; përkundrazi, janë dekada ndryshimesh të forta në planin e demografisë e të orientimit fetar. Por kureshtja u shtua prej klimës së debatit publik e politik, që parapriu vetë censusin. Dhe debati, që vijoi me muaj të tërë, kish të bënte pikërisht me regjistrimin fetar dhe etnik. PBDNJ-ja, de facto partia e pakicave greke në Shqipëri, këmbënguli që regjistrimi të përfshinte edhe identitetin etnik të shtetasve, dhe me këtë shpresonte (të paktën, ky ish nënvizimi i partive shqiptare me sfond nacionalist) që pakica greke të rezultonte më e madhe se sa shifrat zyrtare që mbroheshin, apo pëshpëriteshin, prej kohësh. Parti të tjera, në radhë të parë Aleanca Kuq e Zi, u ra borive të alarmit; ajo shihnte një rrezik te ky regjistrim etnik, i cili po bëhej në një situatë, kur shqiptarët – kjo ish frika – mund të mos e merrnin seriozisht, e mund ta bënin shkel e shko, deklarimin e përkatësisë etnike. Ca e ca i mëshonin idesë se shqiptarët, sidomos ata të fesë ortodokse të gjendur nën presionin apo lezhatimin e qarqeve nacionaliste greke, s'do ta kishin për gjë të adoptonin një qasje të shkujdesur në një rrethanë të tillë. ... Mirëpo INSTAT-i s'do t'ia dijë për kërsërinë tonë, që tek-tuk është dhe interes i natyrës akademiko-kulturore. Pse vallë? Ka që thonë se censusi në këto dy drejtime ka dalë i pavlefshëm, ngaqë një përqindje e madhe njerëzish ka refuzuar të përgjigjet. Është vërtet kështu? Po pse s'na e thonë atëherë? Me ç'të drejtë e me ç'logjikë e mbajnë këtë të dhënë për vete? Pse na lënë neve të rendim pas spekulimeve? Apo ka 'hile' të tjera në këtë mes?*

Në përgjigje të pyetjes së fundit, ka ca të tjerë që thonë se INSTAT-i

është duke pritur që Berisha t'i japë ok-in, pasi e dhëna mbi përkatësinë etnike të shqiptarëve mund të zemërojë grekët (ka dalë një përqindje e vogël grekësh nga regjistrimi, gjë që s'përligj as paranojat e nacionalistëve shqiptarë, që s'lanë gjë pa bërë me synimin për ta demonizuar apriori përmasën etnike të censusit; ndërsa aposteriori janë duke kënduar këngën "rroftë censusi"). Ka ca të tjerë akoma që thonë, se e dhëna mbi identitetin fetar të shqiptarëve mund t'i krijojë Berishës të krisura në marrëdhëniet me komunitetin mysliman, që ka pritur të jetë më i madh në numër (fakti që 70% e popullsisë deklaroi "distançë me fenë" nuk është shenjë e mirë për myslimanët; janë të gjitha gjasat që tek ky 70%-ësh të ketë shumë pak të krishterë). Shkurt, bindja është se INSTAT-i nuk po i publikon këto të dhëna, ngaqë vlerëson se ato janë problematike. Sikur të jetë kështu, lindin pyetjet: Kush është INSTAT-i që mund të bëjë arsyetime të tilla? Mbi ç'bazë i bën këto arsyetime? Ia kërkon Kryeministri? Po Kryeministri kush është që i dhënka të drejtë e tagër vetes të bllokojë apo lejojë publikimin e të dhënave të tilla?"

Një shkrim tjetër mjaft interesant e provokues, që lidhet në një farë mënyre me temën e censusit, por që ka të bëjë më tepër me dallimet esenciale që, sipas autorit, ekzistojnë mes Shqipërisë dhe Kosovës përsa i takon vendit dhe rolit që zë dhe luan feja në dy shoqëritë, është ai i publicistit të njohur **Ardian Vehbiu (Respublika, 15 shkurt 2012)**, me titull "**Mjafton dëshira**". Duhet shtuar se shkrimi i Vehbiut u botua në kontekstin e diskutimeve për projektin e shpallur ndërkohë nga disa forca politike nga të dyja anët e kufirit për mundësinë e bashkimit të Shqipërisë me Kosovën. Sipas A.Vehbiut, një ndër dallimet që ai e quan "*kritik në vetvete*", që e bën të vështirë të përfytyrosh mundësinë e një bashkimi të tillë, "*...lidhet edhe me strukturën sociale-fetare, e cila te shqiptarët paraqitet si një ekuilibër delikat mes tre grupeve fetare (myslimanë, ortodoksë, katolikë, pa përfshirë këtu ndonjë nënsekt, si ai i bektashinjve, ose edhe agnostikët dhe ateistët, të cilët ndër shqiptarë i gjen me shumicë të madhe); ndërsa në Kosovë të dhënat janë ndryshe. Sipas të dhënave të botuara nga gazeta Express e Prishtinës, të cilat po i citoj siç i pashë te Respublica: harta etnike e Kosovës është si*

më poshtë: janë deklaruar shqiptarë 1 milion e 614 mijë e 127 vetë, dhe serbë 25 mijë e 718 persona, por pa llogaritur veriun. Turqit janë 18 mijë e 711. Boshnjakë ka më shumë se turq: 27 mijë e 488. Ashkalinjtë, romët, egjiptianët e goranët së bashku shkojnë në pothuaj 40 mijë vetë. Po harta fetare? Nga të dhënat del se 1 milion e 660 mijë e 598 qytetarë të Kosovës janë të përkatësishë fetare myslimane, 38 mijë e 223 qytetarë janë të besimit katolik, dhe 25 mijë e 685 të besimit ortodoks. Vetëm 1209 qytetarë të Kosovës kanë deklaruar se nuk i përkasin asnjë feje, ndërsa 7077 nuk janë përgjigjur fare se cilës fe i takojnë.”

Më tej Ardian Vehbiu vazhdon:

“Një bashkim i mundshëm i Shqipërisë me Kosovën, nga pikëpamja e strukturës sociale-fetare, do të forconte në mënyrë dramatike komponenten myslimane ndër shqiptarët e shtetit të ri, jo vetëm numerikisht, por edhe për nga cilësia, meqë kosovarët myslimanë e lidhin besimin islam me identitetin më fort se shqipëritarët myslimanë. Logjikisht feja myslimane do të bëhej feja mbizotëruese në shtetin e ri; dhe brenda kësaj feje, elementi sunit do të mbizotëronte ndaj atij bektashi. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, që shteti rezultat i këtij bashkimi të mundshëm do t'i ngjajë Kosovës, nga pikëpamja që po analizojmë, shumë më tepër se çdo t'i ngjajë Shqipërisë. Historikisht, kjo do të thotë që shtetit të ri, ose super-Shqipërisë (më pëlqen ta quaj kështu) t'i fuqizohet edhe fillesa osmane, ose raportet e tij me të shkuarën osmane. Nëse Rilindja kombëtare, në aspektet e saj kulturore, synonte t'i shkëpuste shqiptarët nga Perandoria Osmane jo vetëm politikisht, por edhe historikisht, duke bërë të pamundurën për të sendërgjuar një by-pass me periudhën paraosmane (Skënderbeu, etj.), në shtetin e ri, super-shqiptar, kjo do të rivështrohet detyrimisht. Përveç gjuhës dhe traditave folkloristike, Shqipërinë dhe Kosovën i afron, para së gjithash, e kaluara e përbashkët shumëshekullore nën sundimin osman.”

Po me dallimet që ekzistojnë mes shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të Kosovës përsa i takon religjiozitetit, janë dy shkrime të publicistit nga Kosova **Nexhmedin Spahiu**, i cili duhet thënë se është mjaft aktiv dhe në shtypin e Tiranës. Në shkrimin e tij të parë të titulluar **“Dekontaminimi kulturor”**, (**Panorama**, 29 shtator 2011), duke folur në përgjithësi për atë që ai e konsideron nevojën e

dekontaminimit të kulturës kosovare nga ndikimi që sipas tij ajo ka patur nga Tirana gjatë periudhës së komunizmit, Spahiu kërkon të ashtuquajturin dekontaminim nga ideja se “*Feja na u imponua nga armiqtë, o je me kombin, o je me fenë.*”

Të njëjtën temë ai e zhvillon më tej në shkrimin e datës **6 korrik 2012 (gazeta Panorama) “Profetët dhe lindja e kombeve”**, ku hedh idenë se qëndrimi iluminist për ndarjen e shtetit prej fesë ka sjellë veçse degradim. Sipas tij qytetërimet kanë patur kulmin e tyre vetëm kur zbatuan mësimet e fesë. “*Derisa zbatoheshin ajetet Kur’anore dhe mësimet e profetit Muhamed, civilizimi islam arriti kulmet e civilizimit botëror në histori. Sapo ky zbatim degradoi, civilizimi islam pësoi ngecje dhe shturje. Edhe te krishterimi ndodhi e njëjta gjë.*” Sipas tij, problemi i kohëve moderne është që “*shoqëritë devijuan rrugën që ua trasuan profetët. Nga mishërimi i parimeve morale me Perëndinë u kalua në mishërimin e mbretit apo perandorit me Perëndinë.*” Nga mohimi i ndikimit të iluminizimit për ndarjen e shtetit prej fesë, Spahiu kalon te thënia e famshme e Vaso Pashës për shqiptarinë si feja e vërtetë e shqiptarit, të cilën ai e konsideron si një qëndrim antifetar. Sipas Spahiut: “*Kombi shqiptar, megjithëkëtë, nuk u krijua mbi bazën e antifetarizmit, por mbi bazën e participimit të barabartë të myslimanizmit synit, bektashizmit, ortodoksizmit e katolicizmit, si 4 shtylla të këtij kombi.*” Më poshtë, në të njëjtën linjë, ai përpiket të rrëzojë idealizimin që sipas tij, i është bërë të ashtuquajturës periudhë të Skënderbeut dhe të Rilindjes Kombëtare. “

Feja dhe politika

Tema e përdorimit të fesë nga ana e politikës është në qendër të shkrimit me autor **Ilir Kalemajn “Roli i organizatave fetare në politikë” (Panorama, 14 dhjetor 2011)**, ku autori shtron pyetjen “*Nëse në Shqipëri ekziston potenciali për mobilizim të votës së strukturuar nga komunitetet fetare?*” Ai kujton sesi “*Premtimi për ndërtimin e*

objektit të kultit, apo për kthimin e pronave është përdorur rëndom nga politikanet e të dy krahëve, por këto përpjekje kanë mbetur të limituara, ndonëse kohet e fundit duken tentativa për krijimin e partive me sfond të qarte fetar që synojnë mobilizimin e votës me elektoratin e tyre specifik.” Autori kujton se si gjatë zgjedhjeve të fundit palët politike treguan një vëmendje në rritje ndaj komuniteteve fetare, sidomos atij mysliman, me shpresën se kjo do t’iu sillte më shumë vota. Ai, po ashtu, kujton se është e vërtetë se vitet e fundit ka patur përpjekje për të krijuar parti me sfond të qartë fetar, por se duhet thënë se këto përpjekje kanë rezultuar krejtësisht të dështuara (deri më tani).

Sidoqoftë, mjafton të shfletosh faqet e gazetës RD të kësaj periudhe për të kuptuar se qeveria i ka kushtuar një vëmendje të veçantë bashkësive fetare, sidomos asaj myslimane. Kështu më datë 16 korrik 2012, Gazeta RD boton shkrimin me titull: **“Kryeministri në aktivitetin festiv të Komunitetit Mysliman me rastin e ditëlindjes së Profetit Muhamed”**, me autor **Elvis Kuçin**. Duhet thënë se bëhet fjalë për një veprimtari të organizuar tashmë prej dy-tre vjetësh nga Komunitetit Mysliman shqiptar, me mbështetjen e Fondacionit turk Sema. *“Kryeministri Berisha deklaroi dje, - thuhet në shkrim - se së shpejti, së bashku me Kryetarin e Bashkisë Tiranë do të inaugurohet fillimi i ndërtimit të xhamisë së re. Duke folur në programin festiv, “Profeti Muhamed a.s. - Krenaria e Njerëzimit”, shefi i qeverisë u shpreh se kryeqyteti pret me padurim xhaminë. Ndërsa përshëndeti këtë ngjarje, Kryeministri tha se kjo është një festë e madhe për të gjithë ata që duan të ndërtojnë të ardhmen bazuar në dijen dhe në respektin e madh ndaj Zotit. “Është një nder i veçantë për mua të kremtoj së bashku me ju, të nderojmë së bashku me ju, ditëlindjen e Profetit të të gjithë profetëve, më të dashurit, më të besuarit, të të Gjithëfuqishmit, Profetit Muhamed, të nderojmë sot ditëlindjen e burrit që ndriçoi mendjen e njeriut dhe të njerëzimit, e Profetit që shenjtëroi dijen, mësimin, shkollën e fëmijëve tanë, të njerëzimit. Kjo është një festë e madhe për të gjithë ata që i besojnë Zotit. Kjo është një festë e madhe për të gjithë ata që i besojnë dijes, për të gjithë ata që duan të ndërtojnë të ardhmen bazuar në dijen dhe në respektin e madh ndaj Zotit”,* tha kreu

i qeverisë. Më tej, Berisha thotë: *“këto 20 vjet Komuniteti Mysliman, udhëheqësi i besimit mysliman shqiptar dhe udhëheqësi i besimeve të tjera kanë realizuar në Shqipëri mrekullinë e të gjitha mrekullive, rilindjen shpirtërore të shqiptarëve. Berisha vlerësoi figurën e Profetit Muhamed, si burri që ndriçoi mendjen e njeriut dhe të njerëzimit dhe shenjtëroi dijen dhe mësimin për mbarë njerëzimin.”*

Po në këtë gazetë, organ i Partisë Demokratike të Shqipërisë, botohet shkrimi: **“Muça: Të vihet guri i parë themel i Xhamisë së re”**. “Duke folur në programin festiv, në përkujtim të Profetit Muhamed, i cili sipas fesë islame është dhe vula e profetëve, Muça ftoi Kryeministrin Berisha dhe kryebashkiakun Basha të vënë gurin e parë themel të xhamisë Bajramin që vjen. *“Dëshiroj të falënderoj nga zemra, në emër të të gjithë besimtarëve myslimanë të Shqipërisë, Kryeministrin, Bashkinë e Tiranës për mbështetjen e madhe që na kanë dhënë, në veçanti për ndërtimin e xhamisë së re në Tiranë, e cila shpresojmë që pas kaq vitesh do të bëhet realitet. I ftoj të vëmë gurin e parë themel të xhamisë Bajramin që vjen”*, tha Haxhi Selim Muça. Duhet kujtuar se e gjithë kjo ka të bëjë me premtimin që iu dha KMSH për të ngritur xhaminë e re të madhe të kryeqytetit, në një shesh, aktualisht park, ku Kryetari i mëparshëm i Bashkisë së Tiranës, sot lideri i opozitës, Edi Rama, s’kish pranuar t’ua jepte, duke iu propozuar ta ngrinin atë në një vend tjetër.

Në po të njëjtin numër të gazetës, jepet lajmi për pritjen e veçantë nga ana e Berishës të këngëtarit turk Sami Jusuf, këngëtar këngësh fetare, *“i cili ndodhet në vendin tonë, me ftesë të Komunitetit Mysliman në Shqipëri, për të përshëndetur programin festiv “Profeti Muhamed a.s. - Krenaria e Njerëzimit”, me rastin e ditëlindjes së Profetit Muhamed.”* “Në takim, - shkruhet në shkrim, - Kryeministri vlerësoi edhe kontributin e Fondacionit “Sema”, si mbështetës kryesor të zhvillimit të arsimit nëpërmjet sistemit të medreseve dhe Universitetit Bedër.” Fondacioni Sema është pjesë e lëvizjes guleniste turke.

Shqetësimin për përzierjen e politikës me fenë e shpreh dhe gazeta Tema në një shkrim të datës **2 mars 2012**, të titulluar **“Mediu i jep**

partisë drejtim fetar, Berisha ndjek shembullin e Skënderbeut’. Sipas këtij shkrimi, në një bisedë televizive, Fatmir Mediu, kreu i republikanëve, paskesh theksuar “... se partia e tij do vazhdojë të mbajë qëndrime fetare. Në zgjedhjet e fundit lokale, kur ne vendosëm në mesazhin tonë ‘Me besimin në Zot, familje, pronë, komb’, pati edhe diskutime me shqetësimin që mos t’i jepnim qëndrimeve tona një drejtim fetar. Partia Republikane flet për vlera morale, të cilat kanë ndërtuar një traditë të qëndrueshme në historinë tonë, por ne duhet të pranojmë se këto vlera dhe ky moral janë të lashta pothuaj sa njerëzimi dhe e kanë burimin tek librat e shenjtë, tek besimi në Zot dhe mesazhet e tij. Ky besim jo vetëm nuk krijon probleme, por përkundrazi ndihmon në zgjidhjet e tyre, keqpërdorimi i tyre prodhon probleme.” tha Mediu, sipas shkrimit të gazetës Tema.

Së fundi, një shkrim botuar nga gazetata **Shekulli dhe Tema (12 qershor 2012)** me titull “**SMS e Shpëtim Idrizit për Berishën: Hallall e Allahu qoftë me ne**”. Sipas tij, “*Fotografi i gazetës Shekulli ka mundur të fiksojë celularin e kryeministrit Sali Berisha në momentin që po votohej për presidentin. Ai ka arritur të sjellë se çfarë shkruhej në ekranin e celularit të kryeministrit, i cili ka këmbyer SMS me Vangjel Dulen e PBDNJ dhe me Shpëtim Idrizin e PDIU.... Shekulli ka fiksuar momentin kur kreu i PDIU i shkruan Berishës: OK. Hallall e Allahu qoftë me ne mos më harro matjanin (për humor). Nuk dihet se çfarë nënkupton çështja e matjanit, por të bien në sy notat fetare të komunikimit mes tyre.*”

Shteti, bashkësitë dhe institucionet fetare

Gazeta RD boton shkrimin “**Mbështetje përfundimit të tempullit të kryegjyshitës botërore, Berisha: “Bektashinjtë themeluan doktrinën e shqiptarisë”**”, ku njoftohet se kryeministri Berisha i kishte kërkuar ministrit të Kulturës, Aldo Bumçi që në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë të mbështesë përfundimin e tempullit të Kryegjyshitës Botërore. “Gjatë mbledhjes së qeverisë, ndërsa

prezantoi miratimin e ligjit për përcaktimin e masës së financimit në buxhetin e vitit 2012 për bashkësitë fetare, Kryeministri Berisha bëri thirrje që tempulli i Kryegjyshitës Botërore të inaugurohet me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë.” Më poshtë ky shkrim na jep një tablo interesante të financimeve nga ana e shtetit për bashkësitë fetare në Shqipëri:

“Këshilli i Ministrave, - sqaron artikulli - miratoi përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2012, për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave. Duke u ndalur në kundërshtimet në media se kjo iniciativë e Kryeministrit po pleks fenë me shtetin, Berisha vlerësoi miratimin për të tretin vit radhazi të këtij ligji. “Është përcaktimi i masës së financimit në buxhetin e viti 2012 për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave dhe kjo praktikë u konsolidua për vite të tëra. Kjo iniciativë e Kryeministrit u kundërshtua nga qëndrime kryekëput ateiste, se gjoja po pleks fenë me shtetin. Por nuk ka asgjë të përbashkët dhe jam shumë i gëzuar se ky është viti i tretë që komunitetet fetare kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në infrastrukturën shpirtërore të këtij kombi dhe që janë aksionerë në të gjithë aksionet morale dhe materiale të vendit kanë përqindjen e tyre dhe i garantoj se do ta rrisim atë”, theksoi Berisha. Sipas këtij vendimi, shuma 99 243 000 (nëntëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e dyzet e tre mijë) lekë, është miratuar për financimin e bashkësive fetare, për vitin 2012. Konkretisht, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 28 160 000 (njëzet e tetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të ndarë, si vijon më poshtë: 11 400 000 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës; 14 760 000 (katërmëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar; 2 000 000 (dy milionë) lekë, për rikonstruksionin e kryesisë së KMSH-së. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 24 370 000 (njëzet e katër milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të ndarë, si më poshtë vijon: 19 560 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e

pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës; 4 440 000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë, për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar; 370 000 (treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për riparimin e objektit, kisha Bestrovë. Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 24 720 000 (njëzet e katër milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekë, të ndarë, si më poshtë vijon: 3 960 000 (tre milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës; 20 760 000 (njëzet milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar. Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 21 993 000 (njëzet e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë) lekë, të ndarë, si më poshtë vijon: 3 000 000 (tre milionë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës; 11 993 000 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë) lekë, për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit “Odeoni”; 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshitë Botërore me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit.”

Të njëjtin informacion na e jep **dhe gazeta Shqip më datën 16 shkurt 2012** me shkrimin: **“Shpërndahen mbi 99 milionë lekë për komunitetet fetare”**

“Qeveria mori dje vendimin për të ndarë masën e financimit kundrejt komuniteteve fetare kryesore në Shqipëri për vitin 2012. Për këtë vit, shumën në dispozicion të komuniteteve fetare, të cilat kanë lidhur marrëveshje me qeverinë shqiptare, është 99 243 000 lekë dhe ajo është ndarë mes myslimanëve, ortodoksëve, katolikëve dhe bektashinjve. Ashtu si edhe vitet e tjera, pjesa më e madhe e fondit të qeverisë ka kaluar për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, që ka përfutur shumën prej 28 160 000 lekësh, të cilat Këshilli i Ministrave i ka përcaktuar qartë se për çfarë do të përdoren. “11 400 000 lekë do të përdoren për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës; 14 760 000 lekë për financimin e pagave të arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar

dhe 2 000 000 lekë për rikonstrukcionin e kryesisë së Komitetit të Myslimanëve Shqiptarë”, theksohet në vendimin e djeshëm të qeverisë. Në vendimin e djeshëm, komuniteti katolik ka përfituar një shumë prej 24 720 000 lekësh, duke arritur të përfitojë për 2012-n rreth 400 000 lekë më shumë se komuniteti ortodoks. Për sa i përket Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, këtë vit ka përfituar shumën 24 370 000 lekë. Po kështu edhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfitoi shumën 21 993 000 lekë, nga të cilat 7 000 000 lekë akordohen për shkak të faktit se Kryegjyshata Botërore është me qendër të saj në Tiranë dhe e shtrin veprimtarinë e saj edhe jashtë vendit.”

Çështja e varrezave publike

Pothuajse gjithë shtypi raportoi gjerësisht për debatet që ngjalli propozimi i Bashkisë së Tiranës për krijimin e varrezave murale, propozim ky që gjeti kundërshtimin nga ana e Komunitetit Mysliman. Për të kuptuar thelbin e problemit po mjaftohemi duke dhënë shkurtimisht dy prej këtyre shkrimeve: atë të botuar **në Gazetën Shqiptare**, të datës **12 prill 2012**, me titull **“Varrezat murale, bashkia nis bisedimet me komunitetet fetare”**. Sipas shkrimit *“Bashkia e Tiranës ka nisur bisedimet me komunitetet fetare në lidhje me idenë e ngritjes së varrezave murale, si një zgjidhje për sipërfaqen gjithnjë e më të vogël të tokës në varrezat e kryeqytetit. Myslimanët e kanë kundërshtuar idenë e varrezave murale, duke theksuar se feja e tyre lejon vetëm varrimin në tokë. Kreu i Komunitetit Mysliman, Selim Muça, propozoi që bashkia të gjejë një tjetër zgjidhje, duke siguruar hapësira të reja në periferi ose në fshatra. Ndërsa për komunitetin katolik, dhe atë ortodoks duket se varrezat murale nuk përbëjnë problem.”*

Të njëjtin informacion na e jep dhe e përditshmjia **Panorama**, në numrin e datës **13 prill 2012**, me shkrimin **“Komunitetet fetare, 3 qëndrimet për varrezat murale”** Sipas tij, shkrimi vazhdon: *“Nisur nga situata aktuale, ku në Tiranë sektori i funeraleve është në*

kolaps, po shihet mundësia e një reforme rrënjësore. Por, përpara se Bashkia të ndërmarrë në praktikë këtë iniciativë, do të konsultohet me qytetarët dhe komunitetet fetare. Në kryeqytet vdesin mesatarisht 4000 veta në vit. Gjithkujt që largohet nga kjo jetë i duhet mesatarisht 5 m² tokë e përdorur për një varr. Pra, janë rreth 20 mijë metra katrorë tokë me të cilën duhet të zgjerohen varrezat. Varrezat e Sharrës janë praktikisht të mbyllura dhe momentalisht operohet vetëm me ato të Tufinës. Kjo e bën të domosdoshme që të shikohen mënyrat e rrugët alternative, duke kërkuar vazhdimisht toka të reja për varrezat. Kjo është edhe një çështje principi, pasi ne nuk mund të transformojmë qytetin, mjedisin vetëm në varrezë”, është shprehur Edmond Panariti. Në deklaratën e tij ai është shprehur se kjo e bën të domosdoshme ndërmarrjen e një reforme që do të përqsë standarde, të cilat ekzistojnë në vendet e BE. “Por, në radhë të parë dhe ajo çka është më e rëndësishme, kërkon dhe konsensus e mbështetje popullore, pasi është diçka e re. Bëhet fjalë për të futur disa elemente, siç janë elementet e varrezave murale. Natyrisht, ekziston një ligj-kuadër që e mundëson këtë lloj varreze. Kjo është një risi për ne, sepse pavarësisht se ka edhe precedentë në vendin tonë, p.sh. Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Durrës janë varreza murale, pra nuk është se nuk ka ekzistuar një shembull më parë, por megjithatë, në shërbim publik ky lloj sistemi akoma nuk funksionon”, ka deklaruar Panariti. Nuk dihet si do të veprojë më tej ky institucion kur komuniteti më i madh fetar në vend ka shprehur hapur qëndrimin kundër. “Ne as e kemi pasur ndonjëherë traditë varrezën murale dhe as do ta pranojmë në të ardhmen. Tradita myslimane e ka që trupi të tretet në tokë”. Këtë deklaratë bëri për gazetën kreu i Komunitetit Mysliman, Selim Muça. ... Sipas tij, kjo ide është propozuar kohë më parë edhe nga ish-kryebashkiaku Rama. “Jemi shprehur dhe jemi kundër një ideje të tillë, duke pasur parasysh se është në dinjitetin njerëzor që të varrosen në tokë”, tha Muça.

Dhe së fundi, një pjesë e shtypit raportoi për fjalën e mbajtur nga Ilir Gjoni, deputet i Partisë Socialiste, në Tryezën e Grupit të Punës Për Rendin e Sigurinë, të organizuar nga kjo parti më datën 10 Shkurt

2012. Ndër të tjera, duke konsideruar se *“Rreziku më i madh që i kanoset Shqipërisë është përçarja e popullsisë dhe mungesa e kohezionit social”*, I.Gjoni sheh si faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë përçarje krahas thellimit të ndarjeve veri-jug, faktin se, sipas tij *“Po punohet për ngritjen e mureve ndarëse mes tre besimeve kryesore fetare (disa prej tyre po tentohet të vihen nën kontrollin e rrymave ekstremiste)”*.

Po këtij shqetësimi i bën jehonë në një farë mënyre dhe Mero Baze në editorialin e datës 19 shkurt 2012, të titulluar **“Kriteri Ali-Beu dhe nacionalizmi etnik në Shqipëri”** (gazeta Tema). Shkrimi merr shkas nga një deklaratë e deputetit të PD-së dhe ish-ministrit të Drejtosisë Enkel Alibeja, në të cilën ai e konsideron Kreshnik Spahiun me origjinë jo-shqiptare. *“Një deputet i partisë në pushtet, i keqpërdorur tradicionalisht nga Sali Berisha, me një emër femëror dhe mbiemër turk (Ali Bej), ka hapur një debat delikat mbi nacionalizmin etnik në Shqipëri, duke tentuar të përjashtojë nga të qenit shqiptar, shtetas që sipas tij, nga “legjendat urbane” kanë ardhur në territoret tona gjatë sundimit të perandorisë otomane.”* shkruan Baze. Sipas tij, *“... është e udhës të shihet se qeveria e Sali Berishës po fut vendin në një spirale të rrezikshme, duke provokuar me një nga tezat më antishqiptare dhe më të rrezikshme që fqinjët tanë, sidomos fqinjët sllavë, përdorin ndaj popullsisë së Kosovës dhe një pjese të popullsisë shqiptare me fe myslimane në Shqipëri. Akuza e tyre është se shqiptarët myslimanë të Kosovës dhe të një pjese të Shqipërisë, janë me origjinë nga Azia e largët, të sjellë këtu gjatë periudhës otomane ... Rreziku i parë i madh që sjell të bazuarit mbi sajime të origjinës së largët të një pjese të shqiptarëve, është ndarja e vendit mbi baza fetare, dhe pse jo dhe produkte të luftës etnike bazuar mbi fenë. Kjo është mënyra më e mirë që ortodoksit t'i quajmë grek, myslimanët turq dhe katolikët venecianë të mbetur këtu. Kjo është mënyra reale se si i vihet zjarri këtij vendi dhe si frika nga patriotizmi i një pjese të popullsisë, prodhon si reaksion një fitil benzine, e cila në logjikën e Sali Berishës do të thotë, ose “ky vend është imi, ose pas meje gameti”. Edhe pse shumë njerëz injorojnë prirjet radikale myslimane të një klani në qeverinë Berisha, është evidente se ata janë lidhje personale e fëmijëve të Sali Berishës, të cilët falen pesë herë në ditë për t'u dukur myslimanë, por në fakt e kanë atë një mënyrë për të mbajtur një klan të tyre fanatik në pushtet. Ali-Bej është një prej tyre.”* konkludon Mero Baze.

Shkrime të tjera që lidhen me këtë temë

Ndër shkrimet e tjera të botuara gjatë kësaj periudhe për temën që ka në qendër ky studim, mund të përmendet shkurtimisht shkrimi i gjatë, i botuar në dy numra të gazetës **Republika (6/7 qershor 2012)**, nga **Hulusi Hako**, me titull **“Feja dhe ateizmi”**. Siç dihet emri i Hulusi Hakos është i lidhur me një sërë veprash të botuara në kohën e komunizmit me karakter të theksuar anti-fetar. Që në fillim të shkrimit autori e bën të qartë se shkrimi i tij është në përgjigje *“me disa shkrime në shtyp, sidomos ato të botuara në gazetën “Sot”, si: “Po i bie grimi Atifetes” (29 dhjetor 2011), “Stabiliteti i Shqipërisë, vetëm në se drejtohet nga përfaqësues të komuniteteve fetare” (5 janar 2012), “Katolicizmi shtetëror kërcënon tolerancën fetare në Shqipëri e në Kosovë” (7 janar 2012), “Nacional-laicizmi islam dhe inferioriteti i shqiptarit të Maqedonisë” (28 mars 2012), “Rreziku që i vjen shoqërisë shqiptare në tranzicion” (5 prill 2012), “Fetë kërkojnë lejimin e simboleve dhe lëndë të posaçme në shkolla...” (26 prill 2012) të autorëve Iljasa Salih, Pirro Prifti dhe Olsi Jazexhi e të tjera.”* Sipas autorit *“Të marra në grup, në to gjejmë të fokusuar e të lakuar fenë si faktor vendimtar (gati shpëtimtar) në jetën tonë politiko-shoqërore, si një çelës magjik të kapërcimit të krizave, fatkeqësive e mjerimit që na kanë pllakosur. Gjejmë në to një merak dhe kujdes të disa autorëve laikë për të tillë status dhe rol të feve në hapësirat shqiptare, që na rezulton i tepruar dhe i shtrembër. Secili, operon me besimin që ka zgjedhur dhe e përqafton, që e ka debulesë ose dhe me fenë, në përgjithësi; për këtë dukuri thjesht personale bën vërejtje e sugjerime orientuese, në një këndvështrim që kalon në maksimalizim të rolit dhe apologji të sforcuar të saj në jetën shoqërore.”*

Këtij shkrimi i kthen përgjigje **në gazetën Sot**, që duhet thënë se është gazeta e përditshme që i kushton më shumë vend temës së fesë, **Pirro Prifti** me shkrimin e tij **“Prof. Hulusi Hako dhe aktivizmat e tij marksiste kundër fesë.”** (Gazeta Sot, 12 korrik 2012)

Tjetër shkrim, ç'është e vërteta me karakter më shumë teorik, për vendin e fesë në shoqërinë shqiptare, është ai **Gëzim Tushit** “**Feja dhe sfidat e modernitetit**” (gazeta **Shekulli**, 9 janar 2012). Sipas autorit, sot në Shqipëri “*Ndihet nevoja për riformulime që nuk cenojnë identitetin dhe që ka mundësi të rritin më shumë autoritetin e fesë, besimeve dhe institucioneve fetare në Shqipëri.*”

Për vendin e fesë në shoqërinë tonë diskuton dhe shkrimi me autor **Eirion Senja**, me titull “**Shqiptarët tolerantë, apo janë indiferentë ndaj fesë?**” (**Republika**, 9 mars 2012). Në parantezë, duhet thënë se gazeta on-line Republika, e drejtuar nga Mustafa Nano, është një ndër organet e shtypit shqiptar më të vëmendshme ndaj kësaj teme. Duke e marrë shkas nga fjalët e dy të dërguarave të sekretares Hilari Klinton për çështjen e tolerancës fetare, autori duke e marrë si të mirëqenë faktin se në Shqipëri ekziston bashkëjetesa mes feve, shtron pyetjen interesante nëse “*realisht kemi të bëjmë me tolerancë fetare apo është indiferenca ndaj fesë që na bën neve të mos kemi ‘probleme’ me njëri-tjetrin, duke bashkëjetuar kështu në paqe me disa fe të ndryshme, ndryshe nga disa shtete të tjera?*”

Më tej në shkrim, autori vë në dukje se “*Pavarësisht përkatësisë fetare, studimet tregojnë se numri i praktikantëve të fesë është disa herë më i vogël se ai i jopraktikantëve. Nga ana tjetër, në qytete me traditë si Korça apo Shkodra, të cilat kanë trashëguar gjithashtu pak më tepër traditat fetare krahasuar me qytetet e industrializuara gjatë periudhës së komunizmit, vërehet një ndasi disi më e madhe fetare. Kujtojmë se në Shkodër ka vetëm pak vite që janë shuar debatet mbi vendosjen e kryqeve në majë kodrave apo nëse objekti i kultit në kalanë e Rozafës ishte xhami apo kishë. Kurse në Korçë, dhëndurët myslimanë nuk janë shumë të pëlqyer në familje të krishtera dhe anasjelltas.*”

Gazeta **Shekulli**, datë 18 prill 2012, i lë plot dy faqe të saj shkrimit me titull “**Grua me shami: Nuk preferoj të lind me mjekë meshkuj**” të shkruar nga Emanuela Sako. Shkrimi shoqërohet me një intervistë të Elvis Naçit, drejtor i Mesazhit islam, pranë Komunitetit Mysliman, që e përligj këtë qëndrim me motivet fetare, si dhe me

qëndrimin e mjekut Maksim Gjoni, të titulluar: **“Një grua rrezikoi jetën dhe fëmijën sepse refuzoi mjekun”**.

Mjaft shkrime të kësaj periudhe i kushtohen sërish grindjeve brenda gjirit të Bashkësisë myslimane të Shqipërisë. Kështu **Tema** e datës **14 mars 2012**, boton shkrimin me titull **“Shkarkimi i imamit ndan myslimanët në Shqipëri”**. Sipas shkrimit kjo lëvizje *“shihet si pjesë e një sulmi nga lidershipi i Komunitetit Mysliman, i cili favorizon një degë turke të Islamit përkundrejt klerikëve të edukuar në vendet arabe.”*

Po këtë temë kanë dhe shkrimet **“Antiterrori shoqëron dy imamët e Medresesë” (Gazeta panorama, 25 Prill, 2012); “Ndalimi i Imamit dhe njeriu i ri”, nga Fitim Zekthi (Respublica.al, 29 maj 2012); “Myslimanët petition Muçës: Ktheni imamin e Medresesë!” (gazeta Mapo, 1 qershor 2012).**

Një sërë shkrimesh të kësaj periudhe iu kushtuan të ashtuquajturës paradë të gejve, si dhe më në përgjithësi qëndrimin ndaj homoseksualitetit. Mes tyre mund të veçojmë vetëm disa: Kështu, më **3 prill 2012, gazeta Panorama**, botoi shkrimin **“Ilir Hoxholli: Nevoja e gabuar e një parade.”**, ku autori pretendonte se fliste *“Në emër të moralit”* që sipas tij, *“ka burim hyjnor”*. Në shkrim ai kritikonte heshtjen e komuniteteve fetare për këtë çështje.

“Dështon parada gay? Në shesh vetëm besimtarët myslimanë” e titulloi shkrimin e vet të **datës 17 maj, 2012, gazeta Tema** *“Edhe pse prej muajsh flitet për këtë aktivitet dhe u bë shumë zhurmë, shkruhet në të, duket se doli një flluskë sapuni. Parada gay nuk është mbajtur gjatë ditës së sotme, ndërsa në shesh, shihje vetëm dhjetëra besimtarë myslimanë, që të organizuar në rrjete sociale, kanë dalë të protestojnë për mbrojtjen e familjes.”*

“Pro familjes, pro moralit, pro jetës”, kanë qenë parullat që kanë mbajtur në duar besimtarët myslimanë, që kanë parakaluar në Bulevard.”

“Hoxha i Prizrenit, Ferhati dhe soji i Ekremit” Imer Mushkolaj (Gazeta mapo, 2 prill 2012)

Sigurisht që gjatë kësaj periudhe ka pasur dhe jo pak shkrime që i janë qasur kësaj teme nga një këndshikim i islamit, nganjëherë dhe ekstrem. Në pjesën më të madhe duhet thënë se këto shkrime s'gjejnë vend në shtypin kryesor, por janë të shumtë në faqet on-line me karakter fetar.

Ndër ta do përmendim vetëm disa:

Kështu, **Redi Shehu**, boton shkrimin “**Laicizmi, asnjësi dhe hapësirat publike**” të botuar në faqen **Zëri islam**, si dhe në **gazetën Start**, ku ai e konsideron laicizmin që ekziston në Shqipëri si jakobin. Sipas tij, *“në sjelljen sociale të strukturave shtetërore si bartëse dhe aplikuese të Laicizmit shihet një soj frike nga një, le të themi, “infektim” i hapësirës publike nga sjellje, paraqitje, performanca individuale apo kolektive të religjionit apo religjiozitetit. Kjo lloj frike, ku në disa raste është transformuar në fobi, ka bërë që hapësirat publike të trajtohen si pronë e një grupimi të caktuar njerëzish të cilët janë përfaqësues të ateizmit si mendësi apo agnostikës.”*

Një shkrim me karakter ekstremist ishte dhe ai i botuar në **gazetën Mapo** me titull “**Vëllazëria shqiptaro-turke dhe kërcënimi nga turkofobët katolikë**” me autor **Olsi Jazexhiu**, të njohur për qëndrimet e tij ekstremiste (**Mapo 17 prill 2012**) *“E tani që turku i Ankarasë – edhe pse unë nuk e besoj një gjë të këtillë – më në fund po lëshohet sërish nga Anadulli drejt Ballkanit, kaurët që i ka zënë paniku nga përrallat 500-vjeçare me jatagan, kërkohet që edhe ne, jo-katolikët, të besojmë në legjendat me turq dhe osmanë e të refuzojmë dorën vëllazërore të Turqisë. Nëse nuk e bëjmë një gjë të këtillë, Gurakuqi i Jozefinës na kërcënon se do të organizojë “një çarje të thellë të brendshme, që mund të rezultojë e pariparueshme.” Përgjigja ime për Romeon dhe klanin e tij është kjo: nëse keni takat e jeni seriozë për këtë që thoni, organizojeni këtë çarje, dhe, ashtu si gjyshërit tuaj në kohë të Skënderbeut, hipini anijeve dhe gjeni atë që doni matanë Adriatikut. Ne myslimanët, do jemi rehat këtu ku jemi, me apo pa Turqinë.”* shkruan Jazexhiu ndër të tjera.

SHTYPI KOSOVAR PËR TEMËN E
FESË, LAICITETIT DHE HAPËSIRËS
PUBLIKE

Dy janë tiparet që e dallojnë debatin që zhvillohet në shtypin e Kosovës për raportet mes fesë dhe hapësirës publike, apo laicitetit krahasuar me Shqipërinë: aty ky zë një vend mjaft më të gjerë, duke qenë njëkohësisht mjaft më i ashpër. Duke ndjekur këtë debat është e qartë se në Prishtinë ekziston një shqetësim mjaft më i madh se sa në Tiranë për sa i takon rolit që është duke luajtur, apo që mund të luajë feja (Islami) në shoqërinë apo dhe në politikën kosovare.

Nga ana tjetër, duke vërejtur çështjet e trajtuara, s'është e vështirë të dallosh "kontaminimin" e ndërsjellë mes Shqipërisë dhe Kosovës në këtë fushë.

Pasqyra e mëposhtme shërben jo vetëm për të dhënë një ide të problematikës dhe shqetësimeve me të cilën përballet aktualisht Kosova në këtë fushë, por dhe për të kuptuar se cilat janë si ngjashmëritë ashtu dhe dallimet krahasuar me Shqipërinë.

Për Kosovën periudha e mbuluar është po ashtu, nëntë mujore, çka përfshin tre mujorin e fundit të vitit 2011, periudhë kjo kur Kuvendi i Kosovës debatoi për amendimet në ligjin për arsimin, që kishin të bënin pikërisht me çështjen e pranisë së fesë e simboleve të saj në shkollat publike.

Gallup: Kosovarët qytetarët më religjiozë të Ballkanit, ata të Shqipërisë më joreligjiozët

Këto janë përfundimet në të cilat arrin sondazhi i kryer nga Gallup, për të cilin raporton Augustin Palokaj në shkrimin e tij: **"Feja si platformë politike në Kosovë"** (Koha Ditore, 6.09.2011). Sipas Palokajt: *"Në pyetjen se 'a ka ndikim feja në jetën tuaj të përditshëm' rreth 90 % të kosovarëve janë përgjigjur pozitivisht. Me të njëjtën anketë qytetarët më joreligjiozë kanë dalë të jenë ata të Shqipërisë dhe të Kroacisë. Ndonëse në Kosovë shpesh dëgjohet pohimi se 'feja nuk ka rëndësi' dhe se 'kombi është mbi të gjitha' një konstatim i tillë është*

vështirë për t'u konfirmuar dhe kohëve të fundit është duke u sfiduar. Me motive fetare sot në Kosovë sulmohen edhe figurat më të rëndësishme të historisë kombëtare.” Shkruan Palokaj. Sipas tij, tre janë problemet kryesore shqetësuese:

“Feja padyshim është bërë platformë politike dhe koalicioni aktual qeverisës i Kosovës është dëshmi e këtij fakti.” Për Palokajn që Behxhet Pacolli ai që i pari *“në Kosovë theu tabunë dhe filloi fushatën politike ta lidhë me elemente fetare që në vitin 2007. Tash ai është në koalicion me Partinë e Drejtësisë të Ferid Aganit, - shkruan Palokaj. - e cila ka platformë fetare në veprimin e saj politik. Këtij koalicioni ndoshta përdorimi i fesë për qëllime politike edhe u ka ndihmuar, sepse e kanë kaluar pragun dhe janë jo vetëm në Kuvend, por edhe në Qeveri. Duke qenë në Qeveri, ky koalicion ka arritur të punësojë shumë veprimtarë dhe mbështetës të tyre në strukturat e pushtetit, në mënyrë disproporcionale me përqindjen e votave të fituara në zgjedhje dhe me numrin e vendeve në Kuvend. ... Prandaj është e çuditshme pse në gjithë këtë debat për mësimin e fesë në shkolla dhe për të drejtën e bartjes së shamive nuk është prononcuar kryeministri Hashim Thaçi, ndonëse emri i tij është përfolur publikisht se ai ka premtuar se do të merret vendim pozitiv për këto kërkesa si kusht për lidhje të koalicionit.”*

Shqetësimi i dytë për Palokajn ka të bëjë me faktin që tema e fesë sot në Kosovë është ajo që tërheq vëmendjen më të madhe të lexuesve. *“Vetëm shikoni ueb faqet e mediave në Kosovë... - shkruan ai. - As kallja e kufirit në veri, as papunësia më e madhe në Evropë, as sporti e madje as kabllot e ambasadorëve amerikanë nuk zgjojnë as përafërsisht interesim te qytetarët e Kosovës sesa temat e lidhura me fenë. Edhe në bisedat private në Kosovë pak minuta kalojnë pa ardhur deri te tema e fesë.”* Sipas tij, problemi kryesor për të është që ky debat *“ka degjeneruar në fyerje, nxitje paragyjkimesh, nxitje urrejtjesh dhe kërcënime të hapëta. Kërcënohen deputetët e Kuvendit, gazetat shpallen ‘haram’, fihen figurat e rëndësishme kombëtare dhe bëhen kërcënime ndër më ekstremet.”*

Por shqetësimi kryesor i A. Palokajt ka të bëjë me faktin se ndërsa *“shqiptarët deri sot janë të njohur si popull me shumicë myslimane, por me orientim të qartë europërendimor. Tash kjo mënyrë tradicionale, është duke u sfiduar në Kosovë nga elementet më ekstreme. E ardhmja*

e Kosovës, - sipas tij - do të varet jo nga ajo se sa do të ketë myslimanë në Kosovë, por çfarë orientimi do ta kenë ata. Fetarët e vërtetë nuk janë asnjëherë problem, sepse toleranca është edhe vlerë fetare për ta. Problem janë ata të cilët nxisin urrejtje dhe kërcënojnë e të tillë në Kosovë janë duke u shfaqur gjithnjë e më shumë.” E përfundon ai shkrimin e tij.

Vetëm pak kohë më pas, e njëjta gazetë, më e madhja në Kosovë, boton dy shkrime që paraqesin një tablo të kundërt me atë të Agustin Palokajt: **“Forum 2015: S’ka rrezik nga radikalizmi fetar” (Koha Ditore, 17 nëntor 2011)** dhe **“Kosovarët nuk e kanë problem ekstremizmin fetar, por papunësinë” (18 nëntor 2011)**. Të dy këto shkrime njoftojnë rezultatet e një hulumtimi të opinionit lidhur me rolin e religjionit në shoqërinë kosovare dhe interesin publik për të, të kryera nga qendra për studime humane “Gani Bobi”. Sipas përfundimeve të tij, të paraqitura gjatë një debati në kuadër të Forumit 2015: *“Ekstremizmi fetar nuk paraqet shqetësim për kosovarët, brengë kryesore e tyre janë papunësia dhe varfëria.”* Sqaron Shkëlzen Maliqi, drejtues i projektit, duke shtuar se: *“Jemi koncentruar në disa çështje të cilat janë ngritur kohëve të fundit nga grupet islamike, siç janë bartja e shamive, pastaj disa kërkesa konkrete si ndërtimi i një xhamie në Prishtinë, futja e lëndës së edukatës fetare në shkolla, mendimin e kosovarëve për orientimin përëndimor, për sjelljet e disa grupeve radikale islamike.”* Sipas Maliqit, *“shumica e të anketuarve... kanë një qëndrim të moderuar sa u përket këtyre çështjeve dhe... vetëm një për qind e të anketuarve e konsiderojnë si problem serioz ekstremizmin fetar në Kosovë.”*

Debatet për laicitetin e arsimit publik

Gjatë periudhës së shqyrtuar, “molla e sherrit”, në qendër të polemikave të një numri mjaft të madh shkrimesh, qe ajo e laicitetit të arsimit publik. Pra, e njëjta tematikë si dhe në Shqipëri, me ndryshimin se ky debat (që e parapriu me disa muaj atë në Shqipëri)

në Kosovë që mjaft më i ashpër, duke u shoqëruar madje dhe me manifestime në rrugët e Prishtinës.

Në Kosovë, shkas për këtë polemikë u bë paraqitja në parlament e disa amendimeve të ligjit për arsimin publik, nëpërmjet të cilave kërkohej lejimi i përdorimit të simboleve fetare, si dhe futja e edukatës fetare. Siç dihet, Parlamenti i Kosovës i hodhi poshtë këto amendime. Por sidoqoftë, debati që kjo ngjarje ngjalli nxori në pah nivelin e shqetësimit por dhe të ndarjeve që ekzistojnë në gjirin e shoqërisë kosovare për çështje të tilla.

Sidoqoftë, për të ilustruar më mirë sa thamë, po e fillojmë duke dhënë fragmente të një shkrimi të gjatë të botuar në dy pjesë në gazetën **“Koha ditore (01 shtator 2011)** nga gazetari i njohur kosovar **Halil Matoshi**. Shkrimi titullohej **“Manipulim i pastër politik.”**

“Ky debat, - shkruan Matoshi - do të ishte i mirëseardhur... po të mos fshihet në thelbin e vet tendenca të politizimit të fesë, me të vetmin synim, marrjen e pushtetit politik dhe ndërrimin e fytyrës dhe imazhit tërësisht përëndimor në aspektin gjeokulturor të shoqërisë kosovare, duke mos e fshëhur edhe synimin e ndërrimit të rendit kushtetues dhe demokratik shoqëror dhe dhënies fund sekularizmit të shoqërisë kosovare duke u mbështetur tek postulatet e islamit politik.” Sipas Matoshit, *“Amendimi i Ligjit për Arsimin në Kuvendin e Kosovës qiti në pah tendencën agresive të një pakice profetike (e cila realisht në konfiguracionin e spektrit politik në Kuvendin e Kosovës nuk paraqet më shumë fuqi elektorale se 1%), si uverture në islamin politik, jotradicional dhe jotipik për shqiptarët, në aspektin etnik dhe historiko-gjeografik. Pastaj qiti në pah ... sjelljen cinike dhe retrograde të lëvizjes “Vetëvendosje”, e cila bojkotoi votimin e amendamenteve për të mos marrë anë, thjesht duke lakmuar votat e ‘shematit’”.*

H.Matoshi sqaron se “Deputetët e të tri partive të mëdha, PDK-së, LDK-së dhe AAK-së, ashtu siç edhe pritej, hodhën poshtë amendamentet 7 dhe 8, sado që shpesh argumentet ishin jo shumë bindëse, sepse aparati propagandistik i sponsorëve të këtyre amendamenteve ishte i fuqishëm, manipulues dhe shpesh kërcënues deri në përmasat e shantazhimit të tërë shoqërisë dhe shtetit.” Ajo që e shqetëson më tepër Matoshin janë

efektet që situata të tilla mund të kenë në realitetin e përditshëm, por dhe në kohezionin kombëtar, apo atë shtetëror të Kosovës. Me këtë rast Matoshi vë në dukje se: *“Shqipëria megjithatë është shumë ndryshe dhe shumë përpara në këtë bashkëjetesë reale (krahasuar me Kosovën).”*

Ç’është e vërteta, Gazeta Koha Ditore i kushton mjaft vend këtij debati, duke e shpallur veten si një mbrojtëse të laicitetit. Kështu, kësaj teme i kushtohen dy editoriale të nënshkruara nga vetë drejtoresha e kësaj gazete, **Flaka Surroi (korrik/nëntor 2011)**. Në të parin, të titulluar **“Kërcënimi i myftiut”**, ajo ngre dy probleme kryesore: 1) *“përpjekjen për ta identifikuar kombin me fenë islame nëpërmjet këtyre mendimeve”*. 2) *“gjuha kërcënuese e përdorur në këtë rast nga myftiu Tërnavë që paskësh thënë se ‘në emër të mbrojtjes së integritetit të identitetit fetar islam, BIK-u nuk do të rrinte duarkryq për të shikuar se kush ofendon e kush jo.”*

Flaka Surroi e sqaron më tej qëndrimin e saj në editorialin “Punë inati”: *“Është absolutisht në interes të Kosovës, - shkruan ajo, - ta ruajë identitetin e vet shtetëror laik, ashtu siç e përkufizon Kushtetuta, me respektimin e plotë të të drejtave dhe të lirive themelore ndërkombëtarisht të pranuar. Kjo pa dyshim nënkupton edhe të drejtën për të pasur fe, por që nuk e nënkupton të drejtën për ta imponuar atë.”* (Koha ditore 3 korrik 2011).

Në të njëjtën linjë janë dhe dy shkrimet e **Blerim Latifit**, profesor i filozofisë politike në UP, **“Kontrabanda e shariatit nën etiketën e të drejtave të njeriut”** (Koha Ditore, 8.09.2011) dhe **“Fashizmi islamik kundër Kanunit të Lekë Dukagjinit”** (Koha Ditore, 3 dhjetor 2011).

Interesant është po ashtu një shkrim tjetër i botuar në po këtë gazetë, nëpërmjet të cilit kupton intensitetin e këtij debati në Kosovë. Fjala është për shkrimin e Melihate Tërnkollit *“Diçka po zihet!”* (Koha Ditore 30 qershor 2011), që ka në qendër protestat e zhvilluara rrugëve të Prishtinës për të kërkuar ngritjen e xhamisë së re në qendër të qytetit, si dhe futjen e mësimi fetar në shkollat publike. Të njëjtën temë trajton dhe shkrimi, **“Namaz-protestuesit i kërkojnë kryeministrit shkarkimin e Blerim Latifit”** (Koha ditore

11 korrik 2011), ku bëhet fjalë për kërkesën drejtuar kryeministrit të Kosovës nga ana e lëvizjes islamike “Bashkohu” për “*shkarkimin e menjëhershëm nga funksioni të këshilltarit tuaj politik, Blerim Latifi, i cili më datën 01 korrik 2011 në televizionin publik të Kosovës RTK, në emisionin ‘Target’, me temën ‘Feja në Kosovë’ i ka fyer rëndë myslimanët e vendit tonë.*” Sipas këtij, ndër argumentet në bazë të të cilave kjo lëvizje kërkonte shkarkimin e këshilltarit politik të kryeministrit që dhe se Blerim Latifi paskësh thënë se “*Islami i Gadishullit Arabik është Islami i shkretëtirës i kontaminuar me Islam politik e Islami politik është antiamerikanizmi. Ne jemi të shqetësuar për faktin se një deklaratë e tillë, e bërë nga një zyrtar qeveritar është skandaloze dhe me pasoja negative për shtetin tonë. T’i akuzosh vendet e Gadishullit Arabik se praktikojnë ‘Islam të shkretëtirës’ dhe kultivojnë antiamerikanizëm i dëmton përpjekjet e shtetit tonë për njohje nga këto vende, njohje të cilat aq shumë na duhen.*” Sipas Lëvizjes islamike ‘Bashkohu’, deklaratat e Blerim Latifit “*bëhen shkak që populli i Kosovës të humbë besimin në qeverinë e vendit dhe njëherit bëhen shkak për dëmtimin e imazhit të vendit tonë dhe humbjen e përkrahjes nga vendet mike si Arabia Saudite, Turqia e vende të tjera Islame...*”

Ndër gazetatat e përditshme të Kosovës, ato që mbajnë një qëndrim më të prerë kundër atyre që sipas tyre përbëjnë përpjekje për të cenuar laicitetin e shkollës janë Koha Ditore dhe Express. Gazeta Zëri mban përgjithësisht një qëndrim më të baraspeshuar. Përkundrazi, gazeta ‘Bota Sot’ është përgjithësisht në krah të atyre që kërkojnë amendimin e ligjit për arsimin.

Le të përmendim disa shkrime të tjerë kushtuar kësaj teme, për të kuptuar më mirë argumentet e palëve:

Kështu sipas **Rrahim Sadikut** në shkrimin e tij: “**Ikim nga mundësia e sundimit të imamëve**” (Zëri, 20 mars 2012): “*Një pjesë e madhe e imamëve tanë, të shkolluar e të robotizuar nëpër vende të ndryshme islamike, duan të na kthejnë atje ku nuk kemi qenë as në kohën e Perandorisë Osmane: te dominimi i plotë i mësimëve të sheriatit dhe pushtetit pa kufi të imamëve! Andaj duan që Kosovën e popullin e saj ta shndërrojnë në një imamët fanatik, çfarë sot nuk e ka as Irani e as disa*

shtete të tjera, që bazë kushtetuese e kanë shariatit. Duan ta bëjnë këtë për të na larguar nga e gjitha ajo që në ne është e lindur, është evropiane dhe është bashkëkohëse. ... Një shembull i tillë, po e ndoqëm, pa shkuar shumë kohë, do të bëjë që ne në Kosovë të ndjehemi më turq se turqit e më fanatik se vendet më fanatike islame” përfundon ai.

Në të njëjtën linjë janë dhe shkrime të tilla si **“Ta mbajmë fenë larg shkollave publike”** nga Agon Maliqi (Zëri, 20 mars 2012), apo **“Pse Kosova sekulare?”**, me autor Fahri Xharrën (Zëri, 18 mars 2012).

Përkundrazi **Fadil Lepaj** në shkrimin: **“Cila është feja e shqiptarit?”** (Zëri, 21 mars 2012) është për lejjimin e ngritjes së një xhamie të re të madhe në qendër të Prishtinës, në mënyrë që myslimanët të mos e ndjejnë veten të viktimizuar. Në po të njëjtën linjë është Gëzim Selaci, mësimdhënës në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (Zëri, 20 mars 2012) në shkrimin **“Si të radikalizosh grupet fetare?”**, apo Qemajl Morina te **“Odiseja e Xhamisë së Madhe të Prishtinës”** (Zëri, mars 2012).

Për të kuptuar më mirë kontekstin e këtij debati, ja dhe disa shkrime të tjera të botuara gjatë kësaj periudhe me karakter më tepër informativ: **“Kuvendit i shkojnë kërkesa kundër shamisë në shkolla dhe kundër lëndës fetare”** (Koha Ditore, 28 gusht 2011), ku njoftohet për dy peticione dërguar kryeparlamentarit Jakup Krasniqi nga **“Gratë intelektuale dhe aktivistet për të drejtat e grave të Kosovës”** dhe Këshilli i arsimtarëve të gjimnazit **“Sami Frashëri”** të Prishtinës, nëpërmjet të cilave kërkohej që *“në Ligjin për arsimin parauniversitar të mos inkorporohen dy propozim-amendamente të karakterit fetar që synojnë legalizimin e përdorimit të shamive në shkolla, si dhe futjen e lëndës së edukatës fetare dhe morale në planprogramet mësimore.”* Sipas tyre *“duke u nisur nga fakti se Kosova është shtet laik i definuar me Kushtetutë, si dhe duke marrë parasysh se kombi shqiptar me tri religjione është mbajtur unik duke i dhënë rëndësi kombit para fesë, ne intelektualët dhe aktivistet për të drejtat e grave kërkojmë nga ju si përfaqësues të popullit që t’i mbronni me vendosmëri vlerat shtetërore dhe kombëtare duke votuar kundër amendamenteve të propozuara.”*

“Protestohet për shaminë” nga Besa Kalaja (Zëri, 23 shtator 2011), informon se *“Më pak se 200 protestues i janë përgjigjur të premtën Lëvizjes “Bashkoku”, në kërkesën e tyre për lejimin e shamisë nëpër institucione.”*

Një vend të dukshëm në gazeta kosovare zënë deklaratat e myftiut Tërnavi: **“Tërnavi: Politika jo fyerje Islamit”** (Zëri, 02 janar 2012), ku ai citohet të ketë *“kritikuar ashpër si asnjëherë më parë institucionet e Kosovës të cilat, sipas tij, në vazhdimësi po injorojnë kërkesat e Bashkësisë Islame të Kosovës, sikurse që ishte votimi i djeshëm në Kuvendin e Kosovës kundër përfshirjes së lëndës së mësim-besimit në institucionet shkollore.”*

Një vend të veçantë në këtë zë po ashtu qëndrimi që mbajti ndaj kësaj çështjeje lëvizja “Vetëvendosja” e cila, siç dihet, abstenoj gjatë votimit. Arsyet e këtij qëndrimi politik i sqarojnë me shkrimet e tyre dy liderët kryesorë të kësaj lëvizjeje.

Në shkrimin e tij të titulluar **“Mbulesa” (Koha Ditore 09 gusht 2011 - ribotuar nga gazeta Shekulli 08 gusht 2011)** Sipas Albin Kurtit, gjithë ai shqetësim që vërehej në Kosovë për këtë çështje që *“kryesisht artificial.” “Islamit e krishterimit, - shkruan ai - i bën të rrezikshëm, si asgjë tjetër pikërisht paniku për rrezikun e tyre. Pushteti i Hashim Thaçit është në rrezik, jo kombi shqiptar a identiteti i tij. Sa herë që Thaçit i rrezikohet pushteti, ai përmes mediave të tij sajton rrëfime për rreziqet që i kanosen kombit (sic).”* Kurti përfundon se në vend që të diskutojnë për fenë, *“Zemërimin shqiptarët duhet t’ia kushtojnë Serbisë e Greqisë, privatizimit neoliberal, varfërisë e papunësisë, korrupsionit qeveritar, e kurrësi shqiptarit të religjionit a sektit fetar tjetër.”*

Qëndrimin e Vetëvendosjes e sqaron më tej Visa Ymeri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në shkrimin **“Për arsimim për fetë dhe mbi fetë, e jo edukim dhe udhëzime fetare”** (Koha ditore, 03 gusht 2011). *“Nuk ka asgjë të keqe që nxënësit në Kosovë të arsimohen dhe ta kuptojnë sesi kanë lindur fetë e ndryshme, cilat janë parimet bazë të tyre, cili ka qenë zhvillimi historik dhe aktual i tyre etj. Rëndësia që religjioni në përgjithësi, dhe fetë e ndryshme secila*

veçanërisht, kanë pasur në zhvillimin shoqëror e të dijes botërore, është e pamohueshme. Mirëpo ky arsimim mbi fetë është radikalisht i kundërt me udhëzimin fetar apo edukatën fetare për të cilën po flitet në Kosovë” shkruan ai.

Shqetësimi për praninë në Kosovë të lëvizjeve radikale islamike

Duke gjykuar nga numri i madh i shkrimeve, duket se në një pjesë të opinionit kosovar ka një shqetësim në rritje për këtë dukuri. Më poshtë, po sinjalizojmë disa shkrime me karakter kryesisht informativ:

“Sindikalistët e Bashkësisë Islame duan islamin tradicional në Kosovë” (Koha Ditore, 08 gusht 2011), ku Shoqata Sindikale e Punëtorëve të Bashkësisë Islame të Kosovës kërkon që BIK të distancohet “nga veprimet radikale të kohëve të fundit ... mosdistancimi ndaj elementëve të rinj të besimit islam jep të kuptohet që aty është një koalicion në heshtje me këto shoqata e individë që nuk kanë të bëjnë fare me praktikën tradicionale të aplikimit të islamit në Kosovë.”

“Kosova mban larg elementët radikalë islamikë” (Bota Sot, 28 maj 2012) *“Për shekuj, islami në Kosovë ka qenë konsideruar i moderuar, duke mos pasur ndikim mbi jetën publike, por i praktikuar privatisht. Sot, megjithatë, frika nga përhapja e predikuesve e literaturës të myslimanëve fundamentalistë është një pjesë e realitetit të Kosovës”* thuhet në të.

“Rexhepi thotë se po vëzhgohen lëvizjet e grupeve islamike” (Koha ditore, 30.11.2011), ku njoftohet se Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, i ka bërë thirrje të martën kreut të Bashkësisë Islame të Kosovës që të distancohet nga grupe të caktuara radikale.

“Krasniqi: Kosova, me katolikë radikalë” (Zëri, 25 korrik

2011), njofton se ky klerik, i bërë i njohur kohët e fundit në Kosovë për qëndrime radikale, qenka shprehur në një intervistë për “Express” se *“kush nuk është mysliman, sipas islamit, e ka vendin në xhehenem. Më tej ai thotë se beson që në Kosovë nuk ka radikalizëm islamik, por ka radikalizëm laik dhe katolik.”*

Një tjetër kleriku mysliman, mjaft aktiv në ngjarjet e fundit, i kushtohet shkrimi i gazetës **Zëri (01 korrik 2011); Koha Ditore “Schwartz: Ramiqi ka lidhje me Hamasin”**, sipas të cilit Stephen Suleyman Schwartz, gazetar amerikan i konvertuar në mysliman, autor i shumë artikujve për islamin në Kosovë, e akuzon Fuad Ramiqin se *“po përpiqet t’i shtrijë rrënjët e organizatave islamike radikale edhe në Kosovë”*. Sipas shkrimit, Ramiqi është një ndër personat e arrestuar nga forcat izraelite si pjesëmarrës që i ishte *“bashkuar një karvani për dërgimin e ndihmave në Gaza të Palestinës”*. Po ashtu, Fuad Ramiqi është përfaqësues në Kosovë i Rrjetit Evropian të Myslimanëve (European Muslim Network) *“një organizatë fundamentaliste e kryesuar nga Jusuf al-Qaradawi i lindur në Egjipt, por që jeton në Katar dhe akademiku Tari Ramadan.”* Po sipas Schwartz, *“Fuad Ramiqi – një ish-ushtarak në ushtrinë e ish-jugosllave që iu bashkua ushtrisë boshnjake gjatë luftës së viteve 1992-1995 në Bosnjë-Hercegovinë është themelues i kësaj vëllazërie në Kosovë të quajtur ‘Forumi Mysliman i Kosovës’ i krijuar në vitin 2006.”*

“Islami s’është pengesë për integrim në Evropë” nga **Besiana Xharra (Zëri, 31 korrik 2011)** përmend një intervistë të Xhabir Hamitit, kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, i konsideruar një figurë fetare e moderuar në gjirin e këtij komuniteti, ku ky pranon se ka grupe ekstreme fetare: *“Fatkeqësisht nuk mund të mohojmë se ekzistojnë grupe dhe individë të tillë. - shprehet ai. Ndikimi i këtyre njerëzve është më shumë te njerëzit jointelektualë, të paarsimuar, që nuk janë në gjendje të dallojnë literaturën e mirëfilltë nga ajo jo e mirëfilltë. Në Kosovën e pasluftës është shtypur aq shumë literaturë e pakontrolluar me anë të së cilës mund të them se janë indoktrinuar disa të rinj verbërisht.”* - paskësh thënë ai.

Përkundrazi, Bota Sot boton një sërë shkrimesh që e mohojnë që në Kosovë të ekzistojë ndonjë radikalizëm islamik. Ndër të mund të përmenden **“Në Kosovë nuk ka dhe as nuk do të ketë radikalizëm islam...!”** me autor **Rexhep Elezajn (17 nëntor 2011 Bota sot)**.

Në shkrimin **“Vehabizmi në Kosovë” (26 nëntor 2011 Bota sot)** evidentohen shqetësimet e Bashkësisë Islame të Kosovës për grupet radikale islamike, për të cilat thuhet se po veprojnë nga shtëpitë private dhe *“udhëhiqen nga persona që nuk janë të Kosovës”*. Sipas drejtorit për media dhe veprimtarisë botuese të Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet Sadriu, janë *“futur edhe elemente fetare që kanë devijuar nga praktikimi i Islamit tradicional në Kosovë”*. *“Është e vërtetë, - shkruan ai, - që, sidomos pas luftës, prania e shoqatave të ndryshme nga vende të ndryshme të lindjes dhe të perëndimit në Kosovë ka bërë që të hasim dukuri të reja. Në aspektin islam, kemi diçka të tillë që është e pranishme, siç është praktikimi i namazit - po lidhem konkretisht te namazi, apo te forma e të falurit dhe aty-këtu te dukuria e veshjes, ku hasim njerëz me mjekra të gjata dhe me pantallona të shkurtra që ... në muajt e kaluar kanë organizuar një sërë protestash në Prishtinë, me kërkesat për ndërtimin e një xhamie të madhe në kryeqytet dhe lejimin e bartjes së shamisë në shkollat fillore dhe të mesme.”*

Shqetësime të ngjashme shpreh dhe artikulli **“Religjioni në Kosovë po del nga binarët e vlerave” (22 maj 2012, Koha ditore)**

Interesant është të evidentojmë shkrimin e **Besiana Xharës “Kosova mbyll sytë përpara xhamive ilegale”**, botuar dhe në anglisht në **Balkan insight (12 janar 2012)**, ku ka një informacion për numrin e madh të xhamive që janë duke u ndërtuar vitet e fundit në Kosovë. Duke iu referuar një hulumtimi të *“kryer në disa komuna të Kosovës nga Gazeta Jeta në Kosovë, del se në dhjetë vitet e fundit janë ndërtuar më shumë se 100 xhami pa pëlqim përkatës.”* Sipas shkrimit *“Që nga viti 1999, Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) i ka rindërtuar 113 xhami të dëmtuara gjatë luftës dhe i ka ndërtuar 155 xhami të tjera, falë fondeve të siguruara përmes kanaleve të ndryshme. Hulumtimi i Gazetës Jeta në Kosovë zbuloi se pothuajse të gjitha këto xhami janë*

ndërtuar në mënyrë ilegale.” Sipas shkrimit, nga të dhënat e marra në dhjetor 2010 te BIK, në Kosovë ka gjithsej 660 xhami.

“**Dell: Kosova, model i shtetit islamik**” e titullon shkrimin e saj **Koha Ditore (14 dhjetor 2011)**. Sipas shkrimit, ambasadori amerikan Dell, gjatë një ligjërata të mbajtur në Monmouth University të Nju Xhersit, ku qe e pranishme dhe presidentja e Kosovës, Jahjaga, paska thënë se “*Kosova është tregim i suksesshëm dhe shembull i bashkë-ekzistencës së vlerave perëndimore e islamike.*”

Disa tituj të tjerë për këtë temë, për të plotësuar tablonë: Kështu disa gazeta kosovare botojnë lajmin sipas të cilit presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, s’pranoi të dekretonte emërimin si ambasador të diplomatit Amir Ahmeti, për shkak të “*ngarkesave të tij religjioze*”. “**Koha Ditore/Tema on-line, 27 prill, 2012**) njoftojnë se, “*Ngarkesat e tij (Amir Ahmeti v.j.) religjioze, veçanërisht ato të shprehura publikisht vitin e shkuar për lëndën fetare dhe për bartjen e shamive, kanë rritur presionin e brendshëm që presidentja të mos e emërojë për ambasador. Në cilësinë e deputetit, Ahmeti përdorte kërcënimin për të realizuar agjenda religjioze.*” Amir Ahmeti është aktualisht deputet i Partisë së Drejtësisë, një subjekt i vogël politik, pjesë e koalicionit qeveritar.

Po ashtu, **Gazeta Koha Ditore** dhe **Express** botojnë më **27 qershor 2012**, shkrimin “**Hashim Thaçi ndjek ritualin fetar në Arabinë Saudite.**”

Shtypi kosovar për ngjarjet në Maqedoni

Shtypi kosovar i kushtoi një vëmendje shumë më të madhe sesa shtypi në Tiranë ngjarjeve të muajve të parë të vitit 2012 në Maqedoni, sidomos atyre që pasuan vrasjen e katër të rinjve maqedonas.

Për të ilustruar mënyrën sesi u perceptuan këto ngjarje në Prishtinë, po përmendim disa prej shkrimeve kushtuar atyre:

Në shkrimin “**Lojtarë në terren të huaj**”, me autor gazetarin e

njohur **Enver Robelli (Koha Ditore, 09 maj 2012)**, ndër të tjera thuhet se *“Edhe nëse dëshmohet se arrestimet e fundit janë një montazh i autoriteteve të Shkupit, shqiptarët duhet të hapin një debat kritik mbi rolin destruktiv të elementëve fetarë islamikë në mesin e tyre. Shumica e shqiptarëve në Maqedoni, por edhe në viset e tjera të banuara me shqiptarë në Ballkan nuk kanë rënë pre e joshjeve fundamentaliste. Por nuk mund të mohohet se një pakicë gjithnjë e më agresive përpiqet të imponojë agjendën e saj të prapambetjes. Disa i këndojnë Bin Ladenit, të tjerët propagandojnë sheriatin dhe luftojnë vlerat demokratike perëndimore, teologë me mendësi beduinësh japin leksione për mospërdorimin e Facebook-ut, të tjerët synojnë të marrin nën kontroll xhami dhe me falangat e tyre religjioze të diktojnë se kush është mysliman i vërtetë e kush jo. Në vitin 2010 në xhaminë e Isa Beut në Shkup madje u përleshën fizikisht grupe besimtarësh. Në këtë batërdi ishin të involvuar edhe politikanë, të cilët në mungesë të programeve cilësore për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve besimin e masës synojnë ta fitojnë me anime ndaj grupeve të caktuara fundamentaliste.”* Më tej Robelli vazhdon: *“Dalin shqiptarët për të kërkuar kinse të drejta kombëtare dhe për të protestuar kundër arrestimeve në Maqedoni, por nuk kanë asnjë kërkesë të logjikshme politike. Në vend të tyre çirren “Allahu-Akbar” dhe “Shqipëri Etnike”. Valëvitin flamuj arabë dhe aty-këtu, sa për sy e faqe, ndonjë flamur kombëtar. Protestojnë kundër shtypjes nga shteti maqedonas me flamuj të xhihadit. Nuk bartin plisa, por kryesisht kapuçë piratësh dhe beduinësh Për fat të keq në trenin e popullizmit fetar kacavirren edhe disa politikanë shqiptarë të Maqedonisë. Përzierja e fesë në politikë dhe anasjelltas si dhe zbritja e kërkesave politike në mesazhe fetare vetëm mund të çojë ujë në mullirin e propagandës nacionaliste maqedonase.”*

Në të njëjtën linjë është dhe shkrimi me autor **Ali Cenajn “Haxhiqamilët e Shkupit!” (Gazeta Zëri, 11 maj 2012)**. *“... ajo që u pa rrugëve të Shkupit ishte më shumë se befasuese. Në të vërtetë ishte shokuuese. Ishte e kundërta e asaj që ishte promovuar. Pamjet e turmës që kishte dalë për të protestuar kundër arrestimeve me thirrjet “Allahu ekber, Allahu ekber” si në trans, e ndonjë tjetër thirrje “Shqipëri etnike, Shqipëri etnike” që mbytej në detin e gjelbër të rekuizitave islamiste, deri*

te bajraku me shkronja arabe dhe shpatën e sheriatit nën të, pastaj bluzat me porosinë se “Islami do të pushtojë botën” promovonin të kundërtën e idesë për mbrojtjen e të arrestuarve.” shkruan autori, që vazhdon më tej: “Kush janë këta njerëz që në emër të shqiptarëve promovojnë mendësi e tradita arabe. Kujt i duheshin pamjet e tilla, shqiptarëve dhe interesave të tyre legjitime në këto hapësira apo dikujt tjetër, që rrezikun nga fundamentalizmi i elementit shqiptar po e shet si armën më të fortë kundër nesh. ... Ngatërrimi i kombëtares me fetaren, i qëllimshëm e me shumë hile, bëhet për të dëmtuar të parën, sepse fetarja te shqiptarët në Maqedoni, në kuptimin e islamizmit, nëse nuk ka qenë e privilegjuar, e rrezikuar nuk ka qenë kurrë. Më kot përpigjeni të gjeni ndonjë shembull që dikush të jetë burgosur apo të jetë vrarë për ndërtimin e xhamive, por shumë lehtë mund t’u kujtohet sa u rrahën, u burgosen e madje u vranë për shkollën shqip e Universitet.”

Një qëndrim të kundërt mbajnë një sërë shkrimesh botuar në gazetën Bota Sot, si “**Strugë: Fyhet feja Islame, reagojnë shqiptarët**” (28 janar 2012), apo “**Magogët Serb të Ballkanit**” me autor Musa Lamallarin (25 maj 2012 Gazeta Bota Sot), në të cilin autori sulmon ashpër gjithë ata gazetarë apo politikanë shqiptarë që, sipas autorit, janë kundër fesë islame.

Po kjo gazetë i kushton mjaft vëmendje asaj që është duke ndodhur në vendet arabe, e në përgjithësi në botën islame.

Në përgjithësi, duhet thënë se shtypi kosovar është përgjithësisht më i vëmendshëm ndaj asaj që ndodh në këtë pjesë të botës krahasuar me atë të Tiranës.

“**Një ‘Pranverë Shqiptare’ në Maqedoni**” e titullon shkrimin e saj gazeta **Zëri** (13 maj 2012) ku, ndër të tjera, citohet një deklaratë e dhënë për INA-n (Agjencinë e lajmeve maqedonase) nga ana e shkrimtarit të njohur kosovar **Ramadan Musliu**, i cili shprehet se “*Shqiptarët duhet të lidhen me rrënjët dhe trungun e tyre perëndimor dhe të mos implikohen në reagimet absurde me karakter fetar të nxitura nga Rusia dhe aleatët e tyre sllav në Ballkan. Shqiptarët nuk kanë asgjë me islamizmin prapa të cilit ka tendenca dhe fshihet sllavizmi. Prandaj edhe në rastet e fundit në Maqedoni shqiptarët duhet të distancohen dhe*

të izolojnë grupet radikale islamike.”

Më tej, le të përmendim dhe shkrimet “**Liderët myslimanë në Maqedoni apelojnë për përmbajtje**” (KOHA DITORE, 30 janar 2012); “**Pushteti maqedonas pandeh shqiptarët për terroristë**” (KOHA DITORE, 03 maj 2012); “**Radikalët islamikë i kontrollojnë shërbimi serb**” (10 maj 2012, KOHA DITORE), duke iu referuar një deklaratë të kryetarit të Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi, lidhur me ngjarjet e fundit në Maqedoni. “*Kur këta marrin me aq lehtësi kualifikojnë se këto vrasjet e fundit ishin një akt i radikalëve islamikë, unë me plot përgjegjësi them se radikalët islamikë në Ballkan i kontrollojnë shërbimi sekret serb.*” u shpreh Thaçi; “**Lajthitja fatale e inteligjencës maqedonase**”, shkruar nga Halil Matoshi (10 maj 2012, Koha Ditore); “**Menduh Thaçi: Tendencë groteske për t’i nxirë shqiptarët**” (Koha Ditore, 21 maj 2012)

DISA PËRFUNDIME

Ky vështrim për mënyrën se si shtypi shqiptar ka trajtuar gjatë një periudhe nëntë mujore problematikën që lidhet me raportet që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare mes laicitetit, fesë dhe hapësirës publike, shërben për të na dhënë një panoramë të përgjithshme të çështjeve që ekzistojnë, si dhe gjithë shqetësimeve, frikërave, pretendimeve, pritshmërive dhe ankesave që karakterizojnë debatin. Por, nga ana tjetër, ai të lejon të nxjerrësh dhe disa përfundime:

Së pari, në Shqipëri laiciteti (shekullarizmi), pra parimi i ndarjes së qartë të shtetit nga feja, vazhdon të mbetet një ndër parimet kryesore kushtetuese, i pranuar gjerësisht. Mbetet mendim mbizotërues se parimi i laicitetit qëndron në bazë të asaj bashkëjetese shembullore fetare që vazhdon të karakterizojë jetën shqiptare.

Së dyti, përgjithësisht ekziston një vetëdije e bindje e përhapur për rëndësinë që ka toleranca dhe bashkëjetesa fetare, për të tashmen dhe të ardhmen e vendit, çka mund të sigurohet vetëm duke ruajtur balancat që kanë ekzistuar tradicionalisht në një vend si Shqipëria. Madje, më shumë se kaq, kjo është kthyer në një ndër ato bindje që mund të thuhet se kushtëzon gjithë qasjen e kujdesshme ndaj kësaj teme. Kjo ndoshta shpjegon përse në përgjithësi media shqiptare tregohet aq e kujdesshme sa herë që bëhet fjalë për çështje që lidhen me fenë.

Të vetmet përjashtime janë ato të faqeve apo blogjeve online me karakter islamik, ku kundërshtohet haptazi parimi i laicitetit të jetës publike. Por ato mbeten përgjithësisht periferike, me një ndikim të kufizuar vetëm në qarqe të caktuara.

Së treti, megjithatë, vitet e fundit vërehet një farë tensioni në raportet mes parimit të laicitetit dhe fesë, kur vjen puna te raportet

mes fesë dhe hapësirës publike. Ndërsa deri më sot laiciteti është kuptuar si një përjashtim i fesë dhe i simboleve të saj nga hapësira publike, duke e përcaktuar vendin e tyre vetëm në sferën private, tashmë duket se kjo mënyrë interpretimi e laicitetit është e sfiduar gjithnjë e më shpesh nga qarqe të caktuara. Pikërisht, ky tension përbën dhe objektin kryesor të diskutimeve të periudhës së shqyrtuar në këtë studim.

Në qendër të debateve për këtë temë vazhdon të mbetet shkolla, ose më mirë të themi arsimit parashkollor publik. Prej vitesh ekziston një debat nëse në shkollat publike të vendit të arsimit parashkollor, duhet lejuar apo jo prania e simboleve fetare. Kohët e fundit, ky debat mori përmasa të reja, pas zyrtarizimit të propozimit të Ministrisë së Arsimit për përfshirjen e edukimit fetar në programet mësimore të arsimit parashkollor.

Siç pritej, ky propozim që lidhet drejtpërdrejt me të ardhmen e vendit, ngjalli mjaft diskutime, gjatë të cilave duhet thënë se u ravijëzua një ndarje qëndrimesh mes dy kampeve kryesore politike të vendit. Ndërkohë që e djathta në pushtet duket gjithnjë e më e hapur për të lejuar një prani gjithnjë e më të madhe të fesë në hapësirën publike të vendit, duke përfshirë këtu dhe shkollat publike, e majta politike shqiptare duket se vazhdon t'i qëndrojë besnike një interpretimi më tradicional të laicitetit, duke këmbëngulur që feja e simbolet e saj të mos lejohen të hyjnë në hapësirën publike, e sidomos, në shkollat publike.

Sidoqoftë, duhen venë në dukje tonet mjaft të kujdesshme që u treguan dhe gjatë këtij debati politik.

Së katërti, gjatë kësaj periudhe nis të shfaqet gjithnjë e më qartazi shqetësimi për përdorimin e fesë nga ana e politikës për qëllime elektorale. Kjo ra në sy sidomos gjatë fushatës së fundit të zgjedhjeve lokale. Por po ashtu shfaqet dhe në referencat gjithnjë e më të shpeshta fetare në ligjërimin publik të mjaft prej liderëve politik, sidomos të krahut të djathtë, duke përfshirë këtu dhe kryeministrin e vendit.

Duhet thënë se kjo vazhdon të mbetet sot për sot, ende embrionale, por megjithatë ka ngjallur shqetësime, çka e shprehu publikisht një

prej figurave politike të Partisë Socialiste, deputeti Ilir Gjoni, kur në Tryezën e Grupit të Punës Për Rendin e Sigurinë, të organizuar nga kjo parti, ai foli për kanosjen që është duke iu bërë kohezionit kombëtar dhe për përçarjen e popullsisë.

Sidoqoftë, nëse vërtet do konfirmohen të dhënat e para të bëra publike nga shtypi për sa i takon rezultateve të censusit të përkatësisë fetare të popullsisë, ku nga ajo që njofton shtypi, 70% e shqiptarëve s'pranon të deklarojë përkatësinë e tyre fetare, duke e konsideruar atë diçka private, kjo me siguri do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe në debatin për lidhjet mes laicitetit, fesë dhe hapësirës publike.

Një kapitull i veçantë, kur vjen puna të gjithë skenarët e mundshëm të ndikimit që eventualisht mund të ketë feja në hapësirën publike apo dhe politikën shqiptare, lidhet me ndikimet që vijnë nga jashtë, sidomos ndikimin që vjen nga Kosova apo dhe Maqedonia, tek shqiptarët e së cilës dihet që feja zë një vend mjaft më të dukshëm në jetën kolektive. Kjo për arsyen e thjeshtë se, pavarësisht nga specifikat dhe dallimet që ekzistojnë në këtë aspekt në secilin prej këtyre tre territoreve të banuara nga shqiptarë, s'ka asnjë dyshim se për një mori arsyesh mes tyre ekziston një lidhje e kontaminim reciprok që s'mund të neglizhohet. S'mund të jetë e rastit që vetëm pak muaj pasi në Parlamentin e Kosovës u paraqitën amendimet për lejimin e arsimit fetar në shkollat publike, i njëjti propozim u bë dhe në Parlamentin shqiptar.

Një faktor me mjaft rëndësi në këtë shikim mbetet dhe faktori i integritit në Bashkimin European dhe aftësia e tij frymëzuese.

SOME CONCLUSIONS

This overview of the way in which the Albanian press has treated the range of issues relating to the relationship that exists in Albanian society between secularism, religion and the public space over a period of nine months, serves to present a general overview of all the issues, concerns, fears, claims, expectations and complaints that characterize the debate. On the other hand, it allows one too to draw a number of conclusions:

First, in Albania laicite (secularism), i.e. the principle according to which there is a strict and clear separation between state and religion, continues to serve, and enjoy widespread acceptance, as one of the most important constitutional principles. The dominant opinion is that the principle of laicite lays at the foundation of that exemplary coexistence between different religions that continues to characterize Albanian society.

Second, generally speaking, there exist a widespread awareness and outright conviction about the importance of religious tolerance and coexistence to the present and the future of the country, as well as of the fact that said tolerance and coexistence can be guaranteed only by preserving the equilibria that have traditionally prevailed in a country like Albania. Indeed, this has become one of those beliefs that determine a cautious approach that prevails in all discussions relating to this subject. This in turn, perhaps explains the fact that, generally speaking, Albanian media shows great caution and sensitivity whenever covering issues that concern religion.

The only exceptions to this can be found in web pages or online blogs of Islamic inspiration where the principle of secularism is

openly attacked. But such outlets operate in the fringes of the public debate and enjoy limited influence confined to certain circles.

Third, it must be said that in recent years a certain tension in the relations between secularism and religion, when it comes to the relation between religion and the public space, has become more visible. If up to now secularism was understood as the exclusion of religion and its symbols from the public space, hence confining it to the private sphere, it would seem that this interpretation of secularism is currently being subjected to increasing challenges stemming from certain circles. It is indeed this tension that constitutes the main subject of the debates that took place in the period examined by this study.

Schools, or to be more precise, the public elementary and secondary education system, continues to occupy center stage in these debates. From several years now a debate has been ongoing on whether religious symbols should be allowed in public schools of the elementary and secondary education system. Recently this debate assumed a new dimension after the Ministry of Education officially proposed the inclusion of religious education in the curricula of the elementary and secondary schools. As expected, this proposal which directly concerns the future of the country, caused a lot of discussion, during which one could clearly distinguish a gap in the respective positions of the two, main political camps in the country. While the right, which is currently in power, seems to be increasingly more open to allowing a growing presence of religion in the country's public sphere, the political left seems to remain loyal to a more traditional interpretation of secularism, insisting that religion and its symbols should not be allowed to enter the public sphere, and especially public schools. That said, one should take note of the very cautious tones that were observed during this political debate.

Fourth, during this period, there were clear and growing concerns about the use of religion by politics for electoral ends. This was

especially noticeable during the last electoral campaign for the local elections of 2011. This concern was noticeable too with respect to the growing frequency with which religious reference are used in the public discourse by many of the country's political leaders, especially from the right, and including from the Prime Minister.

It must be said, that for the moment, this development remains at an embryonic stage, but nevertheless, it has given rise to concerns, which were publicly expressed by one of the representatives of the Socialist Party, MP Ilir Gjoni, who during a Round Table of the Socialist Working Group on Security and Public Order, organized by the Socialist Party, spoke of the threat to national unity and of the division of the people.

Nevertheless, if the preliminary data that has been published by the press about the recent census of the population, which included questions on the religious belonging of Albania's citizens, and according to which approximately 70 percent of Albanians refused to declare their religious belonging, since they considered it to be a private matter, will be confirmed, it will certainly have a direct and significant effect on the debate about the relations between secularism, religion and the public sphere.

When discussing the possible scenarios of the influence that religion may gain in the public sphere or even in Albanian politics, one must dedicate a separate chapter to the influences that come from abroad, and especially to those coming from Kosovo or Macedonia, amongst whose Albanian populations, as is known, religion occupies a far more visible place in public life. The reason for this is simple and straightforward: despite the specific differences that exist in all three of these Albanian inhabited territories in this respect, there is no doubt that there exist between them connections and a potential for mutual dissemination of ideas that cannot be ignored. After all, it cannot be a coincidence that mere months after a proposal for allowing religious teaching in public schools was presented to the Parliament of Kosovo, the same proposal was presented to the Albanian Parliament too.